



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Korrik — Dhjetor 2023

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....5

AKTGJYKIME11

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME31

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

* Gjykata aktualisht përbëhet nga tetë (8) gjyqtarë.





Statisti i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 korrik – 31 dhjetor 2023, Gjykata ka pranuar 152 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 364 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 73 kërkesa janë zgjidhur ose 20.05% e të gjitha rasteve në dispozicion.

Gjatë kësaj periudhe, 89 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranura sipas muajve
(1 korrik – 31 dhjetor 2023)*



Në vijim janë paraqitur 16 aktgjykimet që Gjykata i nxori gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 korrik – 31 dhjetor 2023:

- Aktgjykim në rastin KO159/21 dhe KO160/21, parashtruar nga: Komuna e Prishtinës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së “Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit Komunal nr. 020-558/17 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të 12 korrikut 2021 / Vlerësim i kushtetutshmërisë së “Raportit të vlerësimit të ligjshmërisë së aktit Komunal nr. 020-558/10 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të 8 korrikut 2021”.
- Aktgjykim në rastin KO 164/21, parashtruar nga: Komuna e Prishtinës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 6, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.151/2020 i 22 dhjetorit 2020 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Aktgjykim në rastin KI 55/22, parashtruar nga: Sasha Spasiq. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [2022:19820], të 17 majit 2022 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të

Kosovës [Pn1. Nr. 704/2022], të 31 majit 2022.

- Aktgjykim në rastin KI 207/22, parashtruar nga: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i amendamentit të propozuar të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 dhjetor 2022, me shkresën nr. 08/3198/DO-1347/1.
- Aktgjykim në rastin KI 161/21, parashtruar nga: Suzana Zogëjani Sekiraga. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, [Pml. nr. 310/2020], të 28 prillit 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 129/22, parashtruar nga: Sasa Milosavljevic. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj [2022:19820], të 12 gushtit 2022 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës [PN1. nr. 1109/2022], të 5 shtatorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 122/21, parashtruar nga: Lekë Bytyqi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [CPP. nr. 1/2021], të 10 marsit 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 206/21, parashtruar nga: Ukë Salih. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 584/2020], të 22 prillit 2021.
- Aktgjykim në rastin KO 134/21, parashtruar nga: Ramush Haradinaj dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 08-V-036] të 8 korrikut 2021 të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KO 216/22 dhe KO 220/22, parashtruar nga: Isak Shabani dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe Arben Gashi dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.
- Aktgjykim në rastin KI 64/23, parashtruar nga: Mejrem Qehaja Rexha. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së tejzgjatjes së procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në



Gjakovë, përkitazi me lëndën [C.nr.546/18].

- Aktgjykim në rastin KI 21/23, parashtruar nga: “Kelkos Energy” sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [ARJ. UZVP. nr. 119/22], të 16 dhjetorit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 90/23, parashtruar nga: Shqipdon Fazliu. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ.nr.114/2022] të 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ndërlidhur me Aktvendimin [AA.nr.650/2022] e 1 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A.nr.1875/22] e 2 gushtit 2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- Aktgjykim në rastin KO 177/23, parashtruar nga: Komuna e Prizrenit. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
- Aktgjykim në rastin KO 173/22, parashtruar nga: Arben Gashi dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg.
- Aktgjykim në rastin KI 74/22, parashtruar nga: Zoran Đokić. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [Pml.nr.19/2022], të 15 shkurtit 2022.

Llojet e shkeljeve të pretenduara

Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 152 kërkesat e pranuar gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 korrik – 31 dhjetor 2023, janë si në vijim:


- Neni 3 [Barazia para Ligjit] - 8 raste ose 2,4%;
- Neni 7 [Vlerat] - 4 raste ose 1,2%;
- Neni 21 [Parimet e Përgjithshme] - 4 raste ose 1,2%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] - 8 raste ose 2,5%;
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut] - 6 raste ose 1,8%;
- Neni 24 [Barazia para Ligjit] - 37 raste ose 11,3%;
- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] - 9 raste ose 2,8%;
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] - 5 raste ose 1,5%;

- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] - 109 raste ose 33,4%;
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] - 27 raste ose 8,3%;
- Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] - 4 raste ose 1,2%;
- Neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër] - 3 raste ose 0,3%;
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] - 30 raste ose 9,2%;
- Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] - 5 raste ose 1,5%;
- Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] - 8 raste ose 2,4%;
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] - 30 raste ose 9%;
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] - 4 raste ose 1,2%;
- Neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] - 2 raste ose 0,6%;
- Neni 119 [Parimet e Përgjithshme] - 3 raste ose 0,9%;
- Shkelje të tjera - 26 raste ose 7,8%.

Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 138 kërkesa ose 90,8% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 14 kërkesa ose 9,2% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

*Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 korrik – 31 dhjetor 2023)*



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 korrik – 31 dhjetor 2023, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 21 seanca plenare dhe 94 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime.

Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 89 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 16 Aktgjykime (18%);
- 56 Aktvendime për papranueshmëri (62,9%);
- 8 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (9,8%);
- 2 Vendime për masë të përkohshme (2,2 %);
- 7 Urdhëra të tjerë (7,9 %).

*Struktura e vendimeve të publikuara
(1 korrik – 31 dhjetor 2023)*




Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 114 kërkesa nga shqiptarët, ose 91,9%;
- 8 kërkesa nga komuniteti serb, ose 6,5%;
- 1 kërkesë nga komuniteti boshnjak, ose 0,8%;
- 1 kërkesë nga komuniteti slloven, ose 0,8%.

*Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave
(1 korrik – 31 dhjetor 2023)*



19 korrik 2023



Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në vijimësi të organizimit të punëtorive të përbashkëta profesionale, morën pjesë në punëtorinë e radhës të organizuar me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ), e cila u mbajt në Selanik, më 18 – 19 korrik 2023.

Pas fjalëve hyrëse të kryetares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani, kryetarit të Gjykatës Supreme, z. Fejzullah Rexhepi dhe përfaqësuesit të IRZ-së, z. Frank Hupfeld, punëtorja dyditore i vazhdoi punimet me diskutimet e pjesëmarrësve në temat: “E drejta e qasjes në gjykatë”, “E drejta për liri dhe siguri – rastet e paraburgimit” dhe “E drejta në vendim të arsyetuar”, ku me prezantimet e tyre u paraqitën gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese: z. Safet Hoxha, z. Nexhmi Rexhepi, dhe z. Enver Peci, si dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme: z. Shukri Sylejmani, z. Ragip Namani dhe z. Agim Maliqi. Temë diskutimi në punëtorinë e mbajtur ishin edhe çështja e zbatimit të vendimeve të gjyqësorit të rregullt dhe të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, shkëmbimi i informatave relevante me gjyqësorin e rregullt lidhur me rastet në trajtim në Gjykatën Kushtetuese, si dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit reciprok në funksion të lehtësimit të procedurave administrative gjyqësore për palët parashtruese.

Moderator i punëtorisë ishte z. Winfried Schubert, ish-gjyqtar dhe ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të rajonit Saxony-Anhalt, si dhe ish-Kryetar i Gjykatës Rajonale më të Lartë në Naumburg të Gjermanisë, i cili me prezantimet e tij në secilin panel të temave të trajtuara solli perspektivën dhe përvojën e gjyqësorit të rregullt dhe gjyqësisë kushtetuese gjermane.

6 tetor 2023

Gjykata Kushtetuese mori pjesë në tryezën e diskutimit së bashku me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave vendore, organizuar me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara

për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë, e cila u mbajt në hotelin “Swiss Diamond” në Prishtinë.

Pas fjalëve hyrëse të kryetares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani dhe drejtorit të Zyrës për Demokraci dhe Qeverisje në USAID, z. Noel Bauer, tryeza e diskutimit u pasua nga transmetimi i një video-prezantimi përkitazi me procesin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, të realizuar me përkrahjen e USAID.

Gjatë bashkëbisedimit, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave paraqiten pikëpamjet e tyre përkitazi me bashkëpunimin e deritanishëm me Gjykatën Kushtetuese në aspektin e komunikimit, trajtimit të kërkesave të parashtruara për qasje në



informata zyrtare, si dhe interpretimit të drejtë, por edhe keqinterpretimit të përmbajtjes së vendimeve të Gjykatës në opinion.

Të gjithë pjesëmarrësit vlerësuan pozitivisht përkushtimin e Gjykatës për kthimin e përgjigjeve në pyetjet dhe kërkesat e organizatave të shoqërisë civile/mediave brenda ditës apo në afatin prej më së largu 24 orësh, si dhe faktin që Gjykata Kushtetuese deri më tani ka miratuar çdo kërkesë të palëve për qasje në dosjen përkatëse të lëndës pas publikimit të aktgjykimit.

Në fund të diskutimeve, të gjitha palët nënvizuan rëndësinë e organizimit dhe shprehën gatishmërinë e pjesëmarrjes në takime të ngjashme edhe në të ardhmen.

11 tetor 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim njohës shefin e ri të Misionit të EULEX-it në Kosovë, z. Giovanni Pietro Barbano.

Pasi që i shprehu mirëseardhjen dhe i uroi suksese në detyrën e re, kryetarja Caka – Nimani bëri një elaborim të shkurtër përkitazi me punën e deritanishme të Gjykatës, sfidat aktuale në funksionimin e saj dhe angazhimin e bërë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe konsolidimin e

praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Temë e diskutimit të përbashkët ishin edhe zhvillimet e fundit në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës dhe domosdoshmëria e konsolidimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut bazuar në standardet evropiane.

Z. Barbano vlerësoi punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese dhe shprehu zotimin e tij për kontributin e mëtutjeshëm të Misionit të EULEX-it në forcimin e sundimit të ligjit në vend.



23 tetor 2023

Gjykata Kushtetuese kremtoi përvjetorin e 14-të të Vitit Gjyqësor me një ceremoni solemne, që u organizua në "Hotel Emerald" në Prishtinë.

Në ceremoninë morën pjesë udhëheqësit më të lartë shtetërorë, përfaqësuesit e akredituar të misionëve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare në vend, si dhe delegacionet e nivelit më të lartë nga: Gjykata Kushtetuese e Austrisë, Gjykata Kushtetuese e Belgjikës, Gjykata Kushtetuese e Bosnjë dhe Hercegovinës, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, Gjykata Supreme e Estonisë, Këshilli Kushtetues i Francës, Gjykata Supreme e Holandës, Gjykata Supreme e Irlandës, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Gjykata Kushtetuese e Letonisë, Gjykata Kushtetuese e Lituanisë, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë Veriore, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Supreme Administrative e Portugalisë, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë e Shqipërisë, dhe Gjykata Kushtetuese e Turqisë. Pjesëmarrës në ceremoninë e Vitit të 14-të Gjyqësor ishin edhe përfaqësuesit nga Komisioni i Venecias dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me fjalim rasti, pjesëmarrësve në ceremoni iu drejtuan kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, gjyqtari federal dhe këshilltari kryesor i Shteteve të Bashkuara në mbështetje të procesit të hartimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, z. John Tunheim dhe kryetari i Këshillit Kushtetues të Francës dhe njëherësh ish-kryeministri francez, z. Laurent Fabius.



Nëpërmjet një video-adresimi, pjesëmarrësve në ceremoninë solemne iu drejtua edhe presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani – Sadriu.

24 tetor 2023

Në shënim të 14-vjetorit të punës së Gjykatës Kushtetuese, në "Hotel Emerald" në Prishtinë u mbajt Konferenca ndërkombëtare në temën: *"Kontributi i Gjykatave Kushtetuese në mbrojtjen dhe forcimin e vlerave themelore të demokracisë, sundimit të ligjit dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut"*.

Punimet e secilit sesion janë udhëhequr nga gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, në të cilat me diskutimet dhe prezantimet e tyre janë paraqitur kryetarë dhe gjyqtarë



të Gjykatave Kushtetuese e Supreme të: Turqisë, Shqipërisë, Letonisë, Austrisë, Portugalisë, Irlandës, Belgjikës, Bosnjë e Hercegovinës, Bullgarisë, Holandës, Estonisë, Lituanisë, Kroacisë e Maqedonisë së Veriut, si dhe përfaqësues të GJEDNJ-së, Komisionit të Venecias dhe akademikë e personalitete të shquara ndërkombëtare në lëmin e drejtësisë kushtetuese.

27 tetor 2023

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe kryetarja e



Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Bullgarisë, znj. Pavlina Palova, si dhe kryetarët e Gjykatave Kushtetuese të: Republikës së Shqipërisë, Turqisë, Maqedonisë Veriore dhe Malit të Zi, nënshkruan sot në Sofje të Bullgarisë, Memorandumin e Mirëkuptimit, përmes të cilit u themelua Forumi Ballkanik i Gjykatave Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës bëhet për herë të parë anëtare themeluese dhe me të drejta të barabarta e një forumi profesional ndërkombëtar të drejtësisë kushtetuese.

Në cilësinë e Anëtarëve Vëzhgues, pjesë e Forumit Ballkanik të Gjykatave Kushtetuese, që u themelua edhe me përkrahjen e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, janë edhe Gjykata Kushtetuese e Bosnjë dhe Hercegovinës, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, Këshilli Shtetëror i Greqisë dhe Gjykata Kushtetuese e Rumanisë.

31 tetor 2023



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim lamtumirës ambasadorin e deritanishëm të Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Qemal Minxhozi.

Gjatë takimit të përbashkët miqësor, pasi që i shprehu mirënjohjen për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë përgjatë viteve të shërbimit në forcimin dhe thellimin e marrëdhënieve reciproke ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, kryetarja Caka – Nimani e falënderoi ambasadorin Minxhozi edhe për

kontributin e dhënë në kultivimin dhe avancimin e raporteve të bashkëpunimit ndërmjet gjykatave kushtetuese të të dyja vendeve.

Ambasadori Minxhozi e falënderoi kryetaren Caka – Nimani për mirëpritjen e ngrohtë dhe vlerësimin, dhe shprehu zotimin e tij për të vazhduar me angazhimin edhe në nivel personal, në përkrahje të Republikës së Kosovës dhe të institucioneve të saj në rrugëtimin e tyre drejt integriteteve euro-atlantike.

10 nëntor 2023



Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës u mbajt punëtorja informuese me gjyqtarë të sapoemëruar, e organizuar në kuadër të programit të trajnimit fillestar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

Gjyqtarët e rinj u pritën në takim nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, i cili gjatë prezantimit të tij fillimisht diskutoi përkitazi me rolin dhe kompetencat që gëzon Gjykata në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, për strukturën organizative të saj, si dhe palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesave.

Gjyqtari Rexhepi në vijim foli më në detaje përkitazi me procedurat e trajtimit të rasteve, për kriteret e gjykimit të një rasti në kohë të arsyeshme, për shfrytëzimin e aktgjykimeve të Gjykatës si precedent për vendimmarrje për rastet e ngjashme, si dhe për mundësitë që nëpërmjet mekanizmit të kontrollit incidental gjykatat e rregullta t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese.

Gjatë bashkëbisedimit, gjyqtarët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht lidhur me rastet kur Gjykata mund të rishikojë praktikën e saj gjyqësore, dallimin në mes të kontrollit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së akteve, si dhe për aspekte të ndryshme të procedurës së referimit të kërkesave përmes kontrollit incidental.

11 nëntor 2023

Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, z. Bajram Ljatifi, po qëndron për vizitë zyrtare në Sarajevë, me ftesë të organizatave joqeveritare ndërkombëtare "Civic Rights Defender" me seli në Stokholm dhe "AIRE Centre" me seli në Londër. Zëvendëskryetari Ljatifi është ftuar për të



marrë pjesë në Forumin e 10-të Rajonal të Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore, që këtë vit organizohet më 10-11 nëntor 2023, në kryeqytetin e Bosnjë dhe Hercegovinës, në temën: “Balancimi i mbrojtjes së të dhënave me drejtësinë transparente: Korniza ligjore evropiane”.

Forumi Rajonal i Shtetit të së Drejtës është një ndër ngjarjet me rëndësi të vitit për përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor, avokatët e të drejtave të njeriut, komunitetin juridik dhe organizatat joqeveritare në Ballkanin Perëndimor, që për qëllim primar ka promovimin dhe zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nxitjen e bashkëpunimit rajonal për forcimin e sundimit të ligjit, si dhe të ofrojë ndihmë në procesin e integritetit të shteteve të rajonit në Bashkimin Evropian.

27 nëntor 2023



Një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Tiranë.

Vizita e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në kryeqytetin shqiptar është realizuar me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për të marrë pjesë në ceremoninë e miratimit të 25-vjetorit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në konferencën ndërkombëtare të

organizuar me rastin e përvjetorit jubilar. Kryetarja Caka – Nimani ishte njëra ndër folëset kryesore në konferencën ndërkombëtare, në të cilën morën pjesë kryetarë e gjyqtarë të gjykatave kushtetuese evropiane, si dhe përfaqësuesit më të lartë institucional të shtetit shqiptar.

8 dhjetor 2023



Në aktivitetin e radhës “Dita e Gjykatës së Hapur”, organizuar në shënim të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, të premtën, më 8 dhjetor 2023, Gjykatën Kushtetuese e vizituan dhjetëra studentë të fakulteteve juridike dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Gjilanit “Kadri Zeka” ishin në grupin e parë të vizitorëve, që në takim u pritën nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi – Peci. Gjatë prezantimit të saj, gjyqtarja Istrefi – Peci foli rreth historikut të themelimit të Gjykatës Kushtetuese, organizimit punës së deritanishme dhe kompetencave kushtetuese të Gjykatës. Ndërsa, gjyqtari Hoxha bëri një elaborim të shkurtër mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe Ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Gjyqtari Radomir Laban priti në takim grupin e dytë të vizitorëve, të përbërë nga studentë të Klinikës Ligjore të Qendrës për Ndihmë Juridike Falas të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), të cilët i informoi mbi veprimtarinë e deritanishme të Gjykatës, rastet me të cilat Gjykata është marrë së fundi, përfshirë të drejtën në jetë si pasojë e dhunës në familje, si dhe mendimet mospajtuese dhe konkurruese të gjyqtarëve.

Grupi i tretë i vizitorëve në “Ditën e Gjykatës së Hapur” ishin nxënësit e institucionit arsimor për Arsimit Profesional “Hoxhë Kadri Prishtina”, të cilët në takim u pritën nga Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese Bajram Ljatifi dhe gjyqtari Nexhmi Rexhepi. Për derisa Zëvendëskryetari Ljatifi i njoftoi nxënësit në pika të shkurta përkritazi me historikun e së drejtës kushtetuese në vend dhe të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar, gjyqtari Rexhepi bëri një prezantim mbi rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese, mandatin e gjyqtarëve kushtetues, si dhe të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutën e vendit tonë. Aktiviteti “Dita e Gjykatës së Hapur” u përmbyllë me vizitën e studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, të cilët në takim u pritën nga gjyqtarja Selvete Gërzhaliu – Krasniqi, e cila ndër të tjera, juristët e ardhshëm i

informoi përkitazi me raportin e Gjykatës Kushtetuese me gjyqësorin e rregullt dhe mekanizmin e kontrollit incidental, me kriteret e parashtrimit të kërkesave nga qytetarët dhe palët e autorizuar për të parashtruar kërkesë, si dhe me zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

13 dhjetor 2023



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, priti në takim ambasadorin e sapoemëruar të Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj.

Pasi që e përgëzoi për emërimin dhe i uroi suksese në detyrën e re, kryetarja Caka – Nimani e informoi ambasadorin Malaj me punën e deritanishme dhe përbërjen aktuale të Gjykatës, si dhe me zhvillimet e fundit në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës.

Ajo e vlerësoi lart bashkëpunimin institucional të Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë sidomos në fushën e sundimit të ligjit, duke vënë theksin në raportet e shkëlqyera të bashkëpunimit veçanërisht me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë.

Ambasadori Malaj e falënderoi kryetaren Caka – Nimani për mikpritjen dhe shprehu përkushtimin e tij për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve shtetërore të të dyja vendeve.

14 dhjetor 2023

Me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar "IRZ", në Prishtinë u mbajt konferenca e përbashkët ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe Gjykatës Kushtetuese e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, në të cilën gjyqtarët e katër gjykatave shkëmbyen përvojat e tyre reciproke përkitazi me kontrollin e ligjshmërisë dhe të

kushtetutshmërisë në të dyja vendet. Punimet e konferencës filluan me fjalët hyrëse të kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Holta Zaçaj, Kryetarit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, z. Sokol Sadushi, Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Rexhepi, Ambasadorit të Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj, përfaqësuesit të Ambasadës Gjermane, z. Sebastian Leuschner dhe përfaqësuesit të IRZ-së, z. Frank Hupfeld.



Konferenca i vazhdoi punimet nën moderimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Rexhepi, me diskutimet rreth çështjes së kufijve dhe juridiksionit të gjykatave të rregullta në çështjet e kushtetutshmërisë dhe juridiksionet e gjykatave kushtetuese në çështjet e ligjshmërisë, ku me prezantimet e tyre u paraqitën z. Sokol Sadushi, Kryetar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, z. Agim Maliqi, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, znj. Elsa Toska, gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, z. Bajram Ljatifi, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe znj. Gabriele Britz, ish-gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë.

19 dhjetor 2023

Zyrtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës morën pjesë në punëtorinë dyditore mbi standardet e Konventës së Stambollit dhe referencës të tyre në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), organizuar me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, më 18 – 19 dhjetor 2023.

Punëtorja ofroi një platformë me rëndësi diskutimi mbi zbatueshmërinë e dispozitave të Konventës së Stambollit në nivel vendi dhe nevojën për harmonizimin e kornizës legislative vendase me standardet e saj, duke marrë si shembull praktikën e

mira ndërkombëtare dhe rastet me rëndësi nga praktika e GJEDNj-së.



Punëtorja e mbajtur, që u organizua në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës “Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit”, synoi forcimin e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Gjykatës Kushtetuese për të zbatuar standardet e Konventës së Stambollit dhe referencën e saj në aktgjykimet e Gjykatës.

20 dhjetor 2023



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese: znj. Remzije Istrefi – Peci, z. Nexhmi Rexhepi dhe z. Enver Peci, morën pjesë në punëtori të përbashkët me gjyqtarët e gjykatave themelore të Prishtinës, Mitrovicës, Ferizajt dhe Gjilanit, e cila u organizua me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në “Hotel Venus” në Prishtinë.

Temë e diskutimit të përbashkët të gjyqtarëve kushtetues dhe të gjyqtarëve të katër gjykatave themelore ishin, ndër tjerash, ndërveprimi i juridiksionit gjyqësor dhe kushtetues për garantimin e shtetit të së drejtës dhe administrimi i duhur i drejtësisë në kontekst të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e Kushtetutës, baza juridike dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në raport me kontrollin incidental, divergjenca e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta dhe e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si dhe vendosja e rasteve brenda një afati të arsyeshëm kohor, ishin disa prej temave të

cilat gjyqtarët kushtetues i trajtuan në prezantimet e tyre. Punëtorja e mbajtur shënon vazhdimësinë e takimeve konsultative profesionale ndërmjet gjyqtarëve kushtetues dhe gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt, në shërbim të përmirësimit të administrimit të drejtësisë dhe forcimit të sundimit të ligjit në vend.



Aktgjykim

KI 161/21

Parashtrues

Suzana Zogëjani Sekiraqa

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Pml. nr. 310/2020], të 28 prillit 2021

Gjykata, me shumicë votash, vendosi që (i) kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita; dhe (ii) konstatoi se Aktgjykimi [Pml.nr.310/2020] i 28 prillit 2021 i Gjykatës Supreme në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAKR.nr.133/2020] e 3 korrikut 2020 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR.nr.37/2019] e 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 dhe 4 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Aktgjykimi sqaron që rrethanat e rastit konkret, dhe të cilat janë detajisht të shtjelluara në Aktgjykimin e publikuar, ndërlidhen me dënimin e parashtrueses së kërkesës me njëzet e pesë (25) vite burgim për vrasjen e bashkëshortit të saj, përkatësisht të ndjerin A.S., në vitin 2018. Më saktësisht, përmes Aktgjykimit [PKR.nr.37/2019] të 24 janarit 2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, parashtruesja e kërkesës ishte shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale “Vrasje e rëndë”, siç është përcaktuar në pikat 1.3 dhe 1.4 të paragrafit 1 të nenit 179 (Vrasja e rëndë) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Aktgjykimi më tej sqaron që rrethanat që i kanë paraprirë zhvillimit të procedurës penale kundër parashtrueses së kërkesës, përkatësisht faktin që (i) parashtruesja e kërkesës nga viti 2007 deri në vitin 2018, fillimisht para institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës dhe më pas edhe para

autoriteteve të Republikës së Francës, kishte raportuar se ishte viktimë e dhunës në familje; (ii) nga viti 2010 deri në vitin 2018, në periudha të ndryshme kohore, asaj dhe fëmijëve të saj, iu ishte ofruar strehimi nga autoritetet franceze; (iii) në vitin 2018, Gjykata e Lyon-it në Republikën e Francës, e kishte shpallur fajtor dhe dënuar për dhunë në familje tashmë të ndjerin A.S., dhe më pas e kishte liruar me kusht; ndërsa (iv) më 21 shtator 2018, A.S., ishte privuar nga jeta nga parashtruesja e kërkesës e cila më pas, bashkë me fëmijët e saj, ishte kthyer në Republikën e Kosovës, ku ishte lajmëruar në Ambasadën e Republikës së Francës në Republikën e Kosovës dhe më 4 tetor 2018, e njëjta ishte arrestuar nga autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës. Procedura penale në rrethanat e rastit konkret kishte përfunduar me nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar [Pml.nr.310/2020] të 28 prillit 2021 të Gjykatës Supreme.

Parashtruesja e kërkesës, në procedurat para gjykatave të rregullta, nuk kishte kontestuar aktin për të cilin akuzohej, megjithatë përgjatë zhvillimit të procedurës penale ndaj saj, në vazhdimësi, dhe ndër të tjera, kishte kërkuar (i) ekzaminimin përkatës psikiatrik; (ii) ballafaqimin me dëshmitarët dhe dëshmitë e të cilëve ishin marrë nga autoritetet franceze, por të cilat përgjatë zhvillimit të procedurës penale vetëm ishin lexuar gjatë shqyrtimit kryesor dhe parashtruesja e kërkesës nuk kishte pasur mundësinë t'i ballafaqojë në asnjë fazë të procedurës penale; (iii) marrjen parasysh të dëshmive, përfshirë ato të autoriteteve franceze lidhur me faktin që e njëjta ishte viktimë e dhunës në familje; dhe kishte kontestuar (iv) marrjen në pyetje të birit të saj, përkatësisht të miturit, X.X, në cilësi të dëshmitarit gjatë procedurës së zhvilluar në Gjykatën Themelore, pa mbështetje profesionale, përkatësisht pa praninë e psikologut. Kërkesat dhe/ose pretendimet e parashtrueses së kërkesës, ishin refuzuar nga gjykatat e rregullta. Për pasojë, parashtruesja e kërkesës i ngrit të njëjtat pretendime para Gjykatës, duke kontestuar Aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta, me pretendimet që të njëjtat janë nxjerrë në kundërshtim me garancitë procedurale të përcaktuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, me theks, në cenimin e parimit të barazisë së armëve. Në kontekst të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata (i) fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme përkitazi me parimin e barazisë së armëve bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë edhe parimet relevante që burojnë nga

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës, të aplikueshme drejtpërdrejtë në rendin juridik të Republikës së Kosovës dhe me epërsi mbi ligjet e aplikueshme, dhe më pas (ii) aplikoi të njëjtat në rrethanat specifike të rastit konkret. Sipas sqarimeve të shtjelluara në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata, ndër të tjera, fillimisht theksoi se, bazuar në garancitë kushtetuese, çdo i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'iu bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet, garanci këto të cilat janë të saktësuara më tej në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës. Në rrethanat e rastit konkret dhe në kontekst të parimit kushtetues të barazisë së armëve, Gjykata, ndër të tjera, theksoi që në procedurat gjyqësore para gjykatave të rregullta në këtë proces penal, prokuroria dhe mbrojtja nuk ishin trajtuar në mënyrë të barabartë, ndër të tjera, duke marrë parasysh që (i) parashtruesja e kërkesës dhe/ose mbrojtja e saj, në asnjë fazë të procedurës penale, nuk kishin pasur mundësinë e ballafaqimit të dëshmitarëve apo dëshmime të këtyre të fundit, deklaratat e të cilëve ishin lexuar në procesin gjyqësor por që, bazuar në arsyetimet e gjykatave të rregullta, në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim procedural në mënyrë që parashtrueses së kërkesës të mund t'i sigurohej një mundësi e tillë; (ii) kërkesat e parashtrueses së kërkesës dhe/ose mbrojtjes së saj për të paraqitur dëshmitë, përfshirë ato të autoriteteve franceze, bazuar në të cilat do të vërtetohej se e njëjta ishte viktimë e dhunës në familje, ishin refuzuar nga të gjitha instancat gjyqësore; dhe (iii) në rrethanat specifike të rastit konkret, refuzimi i vazhdueshëm i gjykatave të rregullta për të bërë ekzaminimin psikiatrik të parashtrueses së kërkesës është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara në kontekst të rrethanave specifike të rastit përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër të tjera, në Aktgjykimin Gaggl kundër Austrisë, për më tepër marrë parasysh faktin që vet arsyetimi i Gjykatës Themelore përdorë gjuhë paragjyquese ndaj parashtrueses së kërkesës.

Për më tepër, dhe me rëndësi, Aktgjykimi shtjellon parimet dhe standardet e aplikueshme, përfshirë përmes instrumenteve ndërkombëtare, në rastet në të cilat të miturit dëshmojnë në procese gjyqësore. Duke iu referuar nenit 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës, nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, detyrimeve që burojnë nga neni

18 (Detyrimet e Përgjithshme) i Konventës së Stambollit dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata vuri theks në faktin që të gjitha autoritetet publike, përfshirë gjykatat, kanë detyrimin për të mbrojtur interesin më të mirë të fëmijës në procedurë penale dhe se në rrethanat e rastit konkret, gjykatat kishin dështuar të përmbushin këtë detyrim, duke marrë parasysh, ndër të tjera, faktin që i mituri X.X., ishte dëshmitari i vetëm okular në rrethanat e rastit konkret, në një kontekst në të cilin dëshmonte në një rast penal lidhur me vrasjen e babait të tij dhe për të cilin akuzohej nëna e tij, dhe se i njëjti ishte marrë në pyetje pa mbështetje profesionale, përkatësisht pa praninë e psikologut dhe/ose profesionistit adekuat. Gjykata theksoi se, në kuptim të obligimeve pozitive të përcaktuara me Kushtetutë dhe me instrumentet ndërkombëtare, përfshirë edhe praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme për të gjitha autoritetet publike, përfshirë sistemin e drejtësisë.

Bazuar në të lartcekurat, Gjykata konstatoi se aktgjykimet përkatëse të gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe, rrjedhimisht, në kundërshtim me garancitë procedurale të mishëruara në paragrafin 1 dhe 4 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për pasojë, Gjykata shpalli të pavlefshme të njëjtat dhe ktheu çështjen përkatëse penale në rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Në fund, Gjykata vuri theks në faktin që efektet e këtij Aktgjykimi ndërlidhen vetëm me konstatimet në kuptim të garancive procedurale të mishëruara në nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me cenimin e parimit të barazisë së armëve në kontekst të procedurës së zhvilluar penale dhe se e njëjta në asnjë mënyrë nuk paragjykon fajësinë apo rrjedhën e procedurës penale në rivendosje, duke përfshirë por mos u kufizuar në mënyrën e trajtimit të aktakuzës së ngritur kundër parashtrueses së kërkesës lidhur me veprën penale të vrasjes së rëndë për të cilën akuzohet dhe vendimmarrjen përkatëse përkitazi me zgjatjen e paraburgimit, çështje këto të cilat janë në kompetencë të plotë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ashtu siç është përcaktuar përmes dispozitave përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Ky Aktgjykim është plotësuar edhe me mendim mospajtues.



Aktgjykim

KO 134/21

Parashtrues

Ramush Haradinaj dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 08-V-036] të 8 korrikut 2021, të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të lartcekur të Kuvendit është parashtruar në Gjykatë nga dhjetë (10) deputetë të Kuvendit, bazuar në autorizimet e përcaktuara nëpërmjet paragrafit 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Aktgjykimi sqaron që, ashtu siç janë njoftuar të gjitha palët e interesuara pas parashtrimit të kësaj kërkesë dhe deri në dhjetor të vitit 2022, kur ishte dekretuar gjyqtari i radhës në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata nuk kishte pasur kuorum vendimmarrjeje përkitazi me kërkesën KO 134/21.

Në rastin KO 134/21, Gjykata ka vendosur njëzëri që (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme lidhur me efektet e Vendimit të kontestuar. Ndërsa, me pesë (5) vota për dhe dy (2) vota kundër, Gjykata ka vendosur të konstatojë që (i) Vendimi [nr.08-V-036] i 8 korrikut 2021 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] dhe paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës; dhe (ii) konstatimi i lartcekur, përkatësisht Aktgjykimi i Gjykatës, nuk ka efekt prapaveprues dhe nuk afekton të drejtat e fituara të palëve të treta.

Aktgjykimi i Gjykatës fillimisht sqaron që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të transmetuesit publik, përkatësisht Bordit të RTK-së, nga Kuvendi i

Republikës së Kosovës, më 8 korrik 2021. Siç sqarohet detajisht në Aktgjykimin e publikuar, shkarkimit kolektiv i Bordit të RTK-së, anëtarët e të cilit ishin zgjedhur në vitin 2018 dhe 2020, respektivisht, i kishte paraprirë shqyrtimi i Raportit Vjetor të RTK-së për vitin 2020 në Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal dhe në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere, të cilët pas shqyrtimit të të njëjtit, i kishin rekomanduar Kuvendit që (i) të refuzojë miratimin e Raportit të Vjetor për vitin 2020 të RTK-së; dhe (ii) mbi bazën e “paftësisë profesionale” të shkarkojë të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në të njëjtën seancë, përkatësisht atë të 8 korrikut 2021, kishte refuzuar miratimin e Raportit Vjetor të RTK-së dhe kishte shkarkuar të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së.

Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të kontestuar të Kuvendit, duke argumentuar, ndër tjerash, që i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me (i) kompetencën e Kuvendit për mbikëqyrjen e RTK-së sipas paragrafit 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe dispozitave respektive të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, përfshirë nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, respektivisht; dhe (ii) të drejtat dhe liritë themelore të specifikuara të anëtarëve të Bordit të RTK-së. Pretendimet e parashtruesve të kërkesës mbështeten nga komentet e dorëzuara në Gjykatë nga RTK dhe kundërshtohen nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje.

Aktgjykimi vë theks në faktin që, rrethanat dhe pretendimet e lartcekura të këtij rasti para Gjykatës, ndër tjerash, kanë ngritur çështje që ndërlidhen me (i) kompetencën kushtetuese të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të mbikëqyrur punën e institucioneve publike, përfshirë RTK-në, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit dhe kufizimet përkatëse bazuar në Ligjin për RTK-në të miratuar nga Kuvendi; (ii) pavarësinë edhe autonominë e transmetuesit publik, jo vetëm bazuar në Ligjin për RTK-në, por edhe në instrumentet relevante ndërkombëtare, përfshirë ato drejtpërdrejtë të aplikueshme në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës në njërën anë dhe detyrimin e transmetuesit publik për transparencë dhe llogaridhënie ndaj autoritetit mbikëqyrës dhe publikut në anën tjetër; dhe (iii) detyrimet pozitive të shtetit, në këtë rast Kuvendit, që kompetencën e mbikëqyrjes ta ushtrojë bazuar në parimet që burojnë nga Kushtetuta, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe instrumentet tjera ndërkombëtare, përfshirë

Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për të garantuar pavarësinë e transmetuesve publikë dhe lirinë e pluralizmin e medie, marrë parasysh rolin dhe kontributin e tyre thelbësor në një shoqëri të bazuar në vlerat e sundimit të ligjit dhe ato demokratike. Në kontekst të çështjeve të mësipërme, Aktgjykimi fillimisht ka shtjelluar (i) parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kontekst të nenit 10 (Liria e shprehjes) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (ii) përgjigjet e pranuar nga gjykatat kushtetuese dhe/ose ekuivalentet përkatëse anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, përkitazi me statusin/pavarësinë por edhe mënyrën e shkarkimit të anëtarëve të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë. Aktgjykimi më tej gjithashtu ka shtjelluar parimet që burojnë, ndër tjerash, përmes (i) Rekomandimit nr. R (96) 10 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës mbi garantimin e pavarësisë së transmetuesve publikë, përfshirë Shtojcën dhe Memorandumin shpjegues të tij; (ii) Deklaratës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi garantimin e pavarësisë së transmetuesve publikë në shtetet anëtare; (iii) Rekomandimit CM/Rec (2012) 1 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare të Këshillit Evropës mbi qeverisjen e shërbimeve të mediave publike; (iv) Rezolutës së Asamblesë Parlamentare 1636 (2008): Indikatorët për Median në një Demokraci; (v) Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë Opinionin CDL-AD(2005)017 mbi përputhshmërinë e ligjeve “Gasparri” dhe “Frattini” të Italisë me standardet e Komisionit të Venecias në fushën e lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të medias dhe Opinionin CDL-AD(2015)015 mbi legjislacionin për media të Hungarisë; (vi) Raportit të Unionit Evropian të Transmetuesve “Shërbimi i medias publike sipas nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”; dhe (vii) Raportit të Unionit Evropian të Transmetuesve “Fokusi juridik: Parimet e qeverisjes së shërbimit publik të medias”.

Në kontekstin e parimeve që burojnë nga analiza e parimeve kushtetuese, përfshirë dokumenteve të lartcekura, Aktgjykimi fillimisht sqaron që Kuvendi e ushtron funksionin përkatës bazuar në kompetencat e përcaktuara, ndër tjerash, në nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, përfshirë kompetencën për të (i) miratuar ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme; dhe (ii) për të mbikëqyrur punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit. Që të dy këto

kompetenca përbëjnë thelbin e funksionit kushtetues të Kuvendit. Thënë këtë, bazuar, ndër tjerash, në nenet 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, në kontekst të kompetencës kushtetuese të mbikëqyrjes, Kuvendi është i kushtëzuar në ushtrimin e këtij funksioni në pajtueshmëri me (i) dispozitat kushtetuese, përfshirë ato të përcaktuara me nenet: 3 [Barazi para Ligji], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, respektivisht; dhe (ii) kufijtë dhe autorizimet e përcaktuara në ligjet e miratuara nga vet Kuvendi përkitazi me institucionet publike që i raportojnë/mbikëqyren nga Kuvendi. Në kontekst të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës lidhur me transmetuesin publik dhe marrë parasysh rëndësinë thelbësore të lirisë dhe pluralizmit të medie në një rend kushtetues të themeluar mbi vlera demokratike, përtej kufizimeve që përcakton vet Ligji për RTK-në i miratuar nga Kuvendi, rëndësi të veçantë ngërthejnë vlerat kushtetuese të përcaktuara me nenin 7 [Vlerat], nenin 40 [Liria e Shprehjes] dhe nenin 42 [Liria e Medie] të Kushtetutës.

Të njëjtat, në parim dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, përcaktojnë garanci për (i) lirinë dhe pluralizmin e medie; dhe (ii) lirinë e shprehjes, përfshirë të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. Këto dispozita janë gjithashtu të ndërlidhura me nenin 10 (Liria e shprehjes) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe i cili, bazuar në interpretimin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të shtjelluar në Aktgjykim, shtrin garancitë dhe mbrojtjen përkatëse edhe lidhur me pavarësinë e transmetuesve publikë, me theks në detyrimin pozitiv të shtetit për mbrojtjen e tyre nga veprimet arbitrare dhe/ose joproporcionale të vet shtetit, në përputhje me qëllimin legjitim përkatës, gjithnjë me theks në rolin dhe kontributin thelbësor të transmetuesve publikë dhe medie në shoqëritë demokratike. Bazuar në të lartcekurat, Aktgjykimi thekson që garancitë për pavarësinë dhe autonominë e transmetuesit publik, përkatësisht RTK-së, burojnë nga garancitë kushtetuese dhe të instrumenteve të aplikueshme ndërkombëtare përkitazi me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medie sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe vet Ligjit për RTK-në, bazuar në të cilin, ndër tjerash, (i) RTK ka “status të institucionit të pavarur publik me rëndësi të posaçme”; dhe (ii) Kuvendi ka detyrimin për të “mbrojtur autonominë institucionale” të saj. Për më tepër, i njëjti ligj, ndër tjerash dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, përcakton

(i) kufizimet e mbikëqyrjes së Kuvendit mbi RTK-në dhe rrethanat në të cilat mund të ushtrohet kjo mbikëqyrje; dhe (ii) mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së, dispozita këto që interpretohen në dritën e garancive dhe burojnë nga Kushtetuta, dhe/ose parimet e instrumenteve ndërkombëtare në fushën e lirisë e pluralizmit të medias, përfshirë transmetuesit publikë. Aktgjykimi sqaron që bazuar në dispozitat e Ligjit për RTK-në (i) mënyra e zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së është e përcaktuar ashtu që të sigurojë që jo të gjithë anëtarët e Bordit të fitojnë dhe/ose ushtrojnë mandatet përkatëse në të njëjtën kohë, kjo në përputhje me standardet që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare dhe me qëllimin që Bordi i RTK-së të ketë përbërje pluraliste dhe të mos jetë detyrues i zgjedhur nga e njëjta shumicë parlamentare në Kuvend; ndërsa (ii) shkarkimi i anëtarëve të Bordit të RTK-së nga Kuvendi është i mundur, sipas procedurës dhe bazave të saktësuara në këtë ligj, përfshirë për “paaftësinë profesionale”, bazë kjo mbi të cilën, në rastin konkret, janë shkarkuar të gjithë anëtarët e Bordit të RTK-së. Thënë këtë, Aktgjykimi gjithashtu sqaron që një ndër garancitë esenciale lidhur me pavarësinë e strukturave mbikëqyrëse/bordeve të transmetuesve publikë, bazuar në instrumentet ndërkombëtare relevante, përfshirë përgjigjet e gjykatave kushtetuese dhe/ose ekuivalentet e tyre anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, është shkarkimi i anëtarëve të tyre mbi bazë dhe procedurë të përcaktuar dhe të saktë ligjore. Në rrethanat e rastit të shkarkimit të anëtarëve të Bordit të RTK-së përmes Vendimit të kontestuar të Kuvendit, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, kontestuese është nëse ekzistonte baza ligjore për (i) shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së, bazuar në (ii) konstatimin e “paaftësisë profesionale” të Bordit në tërësinë e tij, si rezultat i shqyrtimit dhe refuzimit të miratimit të Raportit Vjetor të RTK-së për vitin 2020. Në këtë kontekst, Aktgjykimi sqaron që (i) bazuar në Ligjin për RTK-në, anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal, ashtu siç përcaktohet edhe përmes Rekomandimit nr. R (96)10 të Komitetit të Ministrave, përkitazi me të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë; (ii) Ligji për RTK-në, nuk përcakton bazë ligjore për shkarkim të Bordit të RTK-së në tërësinë e tij, ndërsa kontributet e dorëzuara nga Forumi i Komisionit të Venecias saktësojnë që shkarkimet kolektive të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesit publik janë të mundshme nga autoritetet mbikëqyrëse vetëm atëherë kur një mundësi e tillë është e përcaktuar specifikisht me ligjin e aplikueshëm; dhe

(iii) Ligji për RTK-në përcakton që RTK i dorëzon “raportin vjetor, raportin mbi debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së në raportin e debatit publik”, Kuvendit të Republikës së Kosovës, “për qëllime orientuese”, dhe për dallim prej rasteve tjera në të cilat ligjvënësi specifikisht përcakton kompetencën miratuese të Kuvendit lidhur me akte të caktuara të Bordit të RTK-së, ky nuk është rasti me Raportin Vjetor. Aktgjykimi në këtë kontekst vë theks në rekomandimet e Unionit Evropian të Transmetuesve, sipas të cilave, autoritetet mbikëqyrëse nuk duhet të kenë kompetencë të miratimit të raporteve vjetore dhe për më tepër, përcaktimi i mundshëm i ligjvënësit që shkarkimi i anëtarëve të bordeve/strukturave mbikëqyrëse të transmetuesve publikë të jetë i mundur edhe bazuar në raportimin vjetor, ndër tjerash, “hap mundësinë për ndërhyrje të papërshtatshme politike, cenon rolin e trupave mbikëqyrës, mund të rezultojë në vetcenzurim përkitazi me përmbajtjen redaksionale”. Bazuar në të lartcekurat dhe shtjellimet tjera në Aktgjykim, Gjykata konstaton që në shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të RTK-së, përkatësisht shkarkimin kolektiv të bordit të transmetuesit publik për “paaftësi profesionale”, të konstatuar përmes shqyrtimit të Raportit Vjetor të RTK-së për vitin 2020, Kuvendi ka vepruar pa bazë ligjore në kontekst të shkarkimit të Bordit në tërësinë e tij, si pasojë e refuzimit të raportit përkatës vjetor dhe rrjedhimisht, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për RTK-në. Për pasojë, në nxjerrjen e Vendimit të kontestuar, Kuvendi ka tejkaluar kufijtë e kompetencës mbikëqyrëse të përcaktuar në paragrafin 9 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe për më tepër, ka cenuar pavarësinë e transmetuesit publikë, roli i të cilit është thelbësor për lirinë edhe pluralizmin e medieve në një shoqëri demokratike, në kundërshtim me vlerat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, në vlerësimin e çështjeve të ngjashme kushtetuese në kontekst të ushtrimit të funksionit të mbikëqyrjes të Kuvendit lidhur me institucionet që i raportojnë të njëjtit në bazë të ligjit, kur ligji i aplikueshëm ka mundësuar shkarkimin e bordeve përkatëse në tërësinë e tyre dhe rrjedhimisht, Kuvendi ka vepruar në përputhje me autorizimet ligjore, siç është rasti i Gjykatës KO139/21 lidhur me shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Gjykata nuk ka konstatuar shkelje kushtetuese. Thënë këtë, legjitimiteti kushtetues i një vendimi të Kuvendit për shkarkimin e anëtarëve të bordit të transmetuesit publik në tejkalim të autorizimeve ligjore, do të përbente një precedent të rrezikshëm për ndërhyrjen e

shtetit në pavarësinë dhe autonominë e transmetuesit publik, përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medieve në Republikën e Kosovës.

Aktgjykimi gjithashtu thekson që parimi i pavarësisë dhe autonomisë së transmetuesve publikë dhe rrjedhimisht, detyrimi i autoritetit mbikëqyrës për të respektuar të njëjtin, është në baraspeshë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies të transmetuesit publik dhe rrjedhimisht, detyrimin përkatës ndaj autoritetit mbikëqyrës, përkatësisht Kuvendit dhe publikut. Anëtarët e bordit të transmetuesit publik, përkatësisht anëtarët e Bordit të RTK-së, i nënshtrohen detyrimeve të Ligjit për RTK-në dhe të gjitha ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe parimeve të llogaridhënies dhe transparencës së plotë ndaj autoritetit mbikëqyrës, në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe instrumente të aplikueshme ndërkombëtare. Konstatimi i Gjykatës përkitazi me Vendimin e kontestuar vë theks në këto parime, duke përfshirë rëndësinë e transmetuesit publik, por edhe detyrimet pozitive të shtetit, përkatësisht Republikës së Kosovës, për të mbrojtur dhe garantuar lirinë dhe pluralizmin e medieve dhe të gjitha garancitë që burojnë nga të drejtat kushtetuese të përcaktuara në kontekst të lirisë së shprehjes dhe të medieve, përfshirë siç është interpretuar nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përcaktuar nga instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Aktgjykimi, në fund, sqaron që ky konstatim i Gjykatës nuk ka efekt prapaveprues dhe bazuar në parimin e sigurisë juridike, nuk afekton të drejtat e fituara të palëve të treta, përkatësisht anëtarëve të rinj të Bordit të RTK-së, zgjedhja nga Kuvendi e të cilëve nuk është kontestuar para Gjykatës. Për më tepër, Aktgjykimi, duke u referuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, sqaron që Gjykata nuk ka kompetencë për akordimin e kompensimit përkatës kur konstaton shkelje kushtetuese, por që një sqarim i tillë, nuk paragjykon të drejtat e anëtarëve të shkarkuar të Bordit të RTK-së përmes Vendimit të kontestuar të Kuvendit, për të ndjekur procedurat përkatëse para gjykatave të rregullta. Ky Aktgjykim do të plotësohet edhe me mendim mospajtues.



Aktgjykim

KO 216/22 & KO 220/22

Parashtrues

Isak Shabani dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe Arben Gashi dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 9, 12, 46 dhe 99 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur lidhur me kërkesat e bashkuara, në rastin KO 216/22, me parashtrues: Isak Shabani dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe KO 220/22, me parashtrues: Arben Gashi dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese bazuar në përcaktimet e paragrafit 5 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik), 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës), 46 (Emërimi dhe mandati në pozitë e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Gjykata (i) njëzëri ka vendosur që të deklarojë kërkesat e pranueshme; dhe (ii) me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër, të konstatojë që procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenet 77 [Komisionet] dhe 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërsa, në lidhje me përmbajtjen e Ligjit të kontestuar, Gjykata, njëzëri ka vendosur që (i) kriteri i “përshtatshmërisë” i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 5 të nenit 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit

7 [Vlerat] të Kushtetutës; (ii) formulimi “si dhe mbikëqyrë implementimin e tyre” i pikës 1.1 të paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i nenit 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 dhe paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 2 të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës; (iii) formulimi “në rastet e parapara sipas këtij ligji” i paragrafit 3 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; (iv) paragrafi 6 i nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafët 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; (v) paragrafi 6 i nenit 67 (Lista e pritjes) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; (vi) paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 të nenit 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (vii) paragrafi 2 i nenit 104 (Shfuqizimi) të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 3 [Barazia para Ligjit], paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushteteve] dhe paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës; ndërsa (viii) me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër që neni 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] dhe nenin 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, Gjykata gjithashtu vendosi: (i) të konstatojë që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Ligji i kontestuar i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje, pa dispozitat e konstatuara në kundërshtim me Kushtetutën dhe sipas specifikave të përcaktuara në Aktgjykimin e Gjykatës; (ii) në pajtim me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, të urdhërojë Kuvendin e

e Republikës së Kosovës që brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e Aktgjykimit, të ndërmarr veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e: (a) paragrafit 6 të nenit 67 (Lista e pritjes); (b) paragrafit 6 të nenit 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) dhe paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 88 (E drejta për ankesë e nëpunëses/it të shërbimit publik) dhe nenit 6 (Nëpunësja/i civil me status të veçantë) të Ligjit të kontestuar, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim; dhe (iii) të përcaktojë që Aktgjykimi hyn në fuqi me publikimin e tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që parashtuesit e kërkesave, në thelb, pretendojnë që (i) procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës; dhe (ii) nenet 9 (Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtares/it publik), 12 (Qeveria e Republikës së Kosovës), 46 (Emërimi dhe mandati në pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues) dhe 99 (Dispozitat kalimtare) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim, ndër tjerash, me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 16 [Epërsia e Kushtetutës], 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës. Në esencë, parashtuesit e kërkesës pretendojnë që Ligji i kontestuar (i) cenon parimet kushtetuese që ndërlidhen me shërbimin civil/administratën publike, me theks në pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, përmes ndërhyrjes dhe mbikëqyrjes së pushtetit ekzekutiv; dhe (ii) cenon të drejtat dhe liritë themelore të zyrtarëve publikë, me theks, në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, ndër tjerash, përmes shndërrimit të pozitave të kësaj kategorie zyrtarësh nga mandati i përhershëm në të përkohshëm, përfshirë me efekt prapaveprues në të drejtat e tyre të fituara, duke rezultuar kështu, ndër tjerash, edhe në mungesë të stabilitetit dhe ndërhyrjeve politike në administratën publike, në kundërshtim edhe me detyrimet e Republikës së Kosovës përkitazi me reformën në administratë publike përmes ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Pretendimet e parashtuesve të kërkesës, në parim, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit, ndërsa kundër-argumentohen nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Të gjitha argumentet dhe kundër-argumentet e palëve para Gjykatës janë të reflektuara detajisht në Aktgjykimin e Gjykatës.

Aktgjykimi më tej sqaron që Gjykata (i) e ka kufizuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar në fushëveprimin e dispozitave të kontestuar nga

parashtruesit e kërkesës dhe atyre të ndërlidhura me to; dhe (ii) përgjatë këtij vlerësimi, ndër tjerash, ka shtjelluar dhe aplikuar parimet e përgjithshme të vendosura nga Gjykata, me theks në Aktgjykimin në rastin KO203/19, përkitazi me vlerësimin e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJENDJ), Opinionet dhe Raportet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë edhe kontributin e gjykatave kushtetuese dhe/ose ekuivalentëve përkatës anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe parimet themelore të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD/SIGMA) për administratën publike.

Në Aktgjykimin e Gjykatës, parimet e lartcekura, janë aplikuar në shqyrtimin e secilit nen të vlerësuar të Ligjit të kontestuar. Thënë këtë dhe për qëllime të kësaj përmbledhjeje, Gjykata do të sqarojë të gjeturat dhe konstatimet kryesore përkitazi me Ligjin e kontestuar, përkatësisht: (i) procedurën e ndjekur nga Kuvendi për miratimin e Ligjit të kontestuar; (ii) pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese në raport me kompetencën mbikëqyrëse të Qeverisë; (iii) përcaktimin e mandateve të kufizuara lidhur me pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike; (iv) efektin e kufizimit të mandateve ndaj zyrtarëve publikë që aktualisht ushtrojnë funksione të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike; (v) të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë që vendosen në “Listat e Pritjes” të administratës publike; (vi) “përshtatshmërinë” si kriter për t’u pranuar në detyrën e zyrtarit publik në administratën publike; dhe (vii) garancitë dhe të drejtat kushtetuese për mjet juridik efektiv dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave të zyrtarëve/nëpunësve të administratës publike.

• *procedura e ndjekur nga Kuvendi për miratimin e Ligjit të kontestuar*

Aktgjykimi fillimisht sqaron që, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës dhe me Rregulloren e Kuvendit, duke vënë theks, ndër tjerash, në faktin që i njëjti, është miratuar në Kuvend pa u shqyrtuar në komisione të përhershme, përkatësisht, “është miratuar pa u shqyrtuar fare në Komisionin e Përhershëm për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim”.

Në vlerësimin e këtij pretendimi, Aktgjykimi fillimisht sqaron që Ligji i kontestuar është shqyrtuar në Kuvend sipas Vendimit [Nr.08-V-449] të Kuvendit të 15 dhjetorit 2022, të nxjerrë bazuar në nenin

123 (Shmangia nga afatet procedurale) të Rregullores së Kuvendit për shmangie nga afatet procedurale, dhe përmes këtij vendimi, është kërkuar nga komisionet e përhershme që komentet përkatëse, t’ia dorëzojnë Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, deri në afatin e përcaktuar përmes vendimit të lartcekur. Po ashtu, bazuar në shkresat e lëndës, rezultojnë që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, ka dorëzuar kontributin përkatës, ndërsa ky nuk është rasti edhe me Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere. Në kontekstin e lartcekur dhe duke marrë parasysh, (i) përmbajtjen e nenit 77 të Kushtetutës, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit, e cila saktëson kompetencën e Kuvendit për të emëruar komisionet e përhershme dhe funksionale, ndërsa delegon përcaktimin e procedurave respektive në nivel të Rregullores së Kuvendit; dhe (ii) përmbajtjen e nenit 78 të Kushtetutës lidhur me Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve – i vetmi komision procedura përkitazi me të cilin është e përcaktuar në Kushtetutë, që saktëson se pas kërkesës të anëtarit të Kryesisë së Kuvendit dhe vendimmarrjes së komisionit të lartcekur, i njëjti ka afat deri në dy (2) javë për të bërë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar, por meqenëse në rrethanat e rastit konkret, ky komision, ka dorëzuar komentet përkatëse në komisionin funksional, atëherë Gjykata duhet të konstatojë që procedura përkitazi me nxjerrjen e Ligjit të kontestuar, nuk është argumentuar të jetë në kundërshtim me nenet e lartcekura të Kushtetutës.

Thënë këtë, dhe në kontekst të përdorimit të nenit 123 të Rregullores, përkatësisht shmangies nga afatet procedurale nga ana e Kuvendit përgjatë procesit ligjvënës, Gjykata vë në pah dy çështje: (i) përcaktimin e vet Kuvendit, përmes miratimit të neneve 85 (Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve) dhe 86 (Procedura e urgjente për shqyrtimin e projektligjit) të Rregullores së punës së tij, që procedurës së përshpejtuar dhe/ose urgjente të shqyrtimit të projektligjeve t’i nënshtrohen vetëm projektligjet që ndërlidhen me sigurinë kombëtare, shëndetin publik, çështjet buxhetore dhe financiare, ose marrjen e masave për gjendjen e jashtëzakonshme sipas nenit 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, ndërsa Ligji i kontestuar qartazi nuk përkon me këto kategori; dhe (ii) përcaktimin e Kuvendit që përmes nenit 123 të Rregullores së tij, të mundësojë shmangien e afateve procedurale të përcaktuara me Rregulloren e punës, me shumicë më të ulët se ajo që kërkohet për miratimin e Rregullores së punës, përkatësisht dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, përcaktuar sipas nenit 76 [Rregullorja e



Punës] të Kushtetutës. Aktgjykimi, në kontekstin e lartcekur, sqaron që para Gjykatës nuk është kontestuar përputhshmëria me Kushtetutën e nenit 123 të Rregullores së punës, megjithatë, rikujton që ushtrimi i pushtetit legjislativ është funksioni primar dhe më thelbësor i Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç është përcaktuar në nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 63 [Parimet e Përgjithshme] dhe 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës dhe se këtë funksion, sipas nenit 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, përfaqësuesit e popullit janë të detyruar ta ushtrojnë në pajtim me Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.

- *lidhur me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese në raport me kompetencën mbikëqyrëse të Qeverisë*

Në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për cenimin e pavarësisë së institucioneve të pavarura kushtetuese përmes nenit 12 të Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi fillimisht sqaron që kjo dispozitë duhet të interpretohet ndërlidhur me nenin 13 (Ministria përgjegjëse për administratë publike) të tij, i cili saktëson mënyrën e zbatimit të nenit 12, si dhe ndërlidhur me nenin 104 (Shfuqizimi) të tij, i cili shfuqizon çdo dispozitë të ligjeve tjera që është në kundërshtim me Ligjin e kontestuar. Aktgjykimi në këtë aspekt, ndër tjerash, sqaron që (i) sipas nenit 12 të Ligjit të kontestuar, Qeveria e Republikës së Kosovës miraton dhe koordinon politikat e përgjithshme shtetërore për punësimin e zyrtarëve/it publik, si dhe “mbikëqyr implementimin e tyre”; (ii) sipas nenit 13 të Ligjit të kontestuar, Ministria përgjegjëse për administratë publike, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme, ndër tjerash, është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe legjislationit për zyrtarët publikë në institucionet e administratës shtetërore, merr nga institucionet e Republikës së Kosovës çdo informacion të nevojshëm në fushën e marrëdhënies së punës dhe është i vetmi institucion shtetëror që ka kompetencë për të ofruar shpjegime lidhur me rregullimet e Ligjit të kontestuar; ndërsa (iii) sipas nenit 104 të Ligjit të kontestuar, me hyrjen në fuqi të tij, “shfuqizohet çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të lartcekura të Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi, duke shtjelluar parimet kushtetuese të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe atyre të përcaktuara përmes praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore në kontekst të institucioneve të pavarura kushtetuese, përfshirë ato lidhur me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës, vë theks në dy çështje thelbësore: (i) pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese të

përcaktuara me Kushtetutë, përfshirë atë të Agjencive të Pavarura të themeluara nga Kuvendi sipas përcaktimeve të nenit 142 [Agjencitë e Pavarura] të Kushtetutës; dhe (ii) funksionin kushtetues të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës, sipas përcaktimeve të nenit 101 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës.

Përkitazi me çështjen e parë, Aktgjykimi sqaron që bazuar në Ligjin e kontestuar, i njëjti aplikohet përkitazi me nëpunësit e institucioneve të përcaktuara në kapitujt IV, V, VII, VIII dhe XII të Kushtetutës, lidhur me Kuvendin, Presidencën, Sistemin e Drejtësisë, Gjykatën Kushtetuese dhe Institucionet e Pavarura të përcaktuara me Kushtetutë, për aq sa “nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”. Për më tepër, Ligji i kontestuar, kategorizon nëpunësit e institucioneve të lartcekura si “nëpunës civil me status të veçantë”, rregullimi i marrëdhënies së punës të të cilëve, bëhet me ligj dhe akte të veçanta, nën kushtëzimin e fushëveprimit të lejuar nga vet Ligji i kontestuar, por edhe nën mbrojtjen e parimit të pavarësisë së garantuar kushtetuese. Sipas sqarimeve të Aktgjykimit, në parim, një rregullim i tillë, nuk bie ndesh me parimet kushtetuese të balancimit dhe ndarjes së pushteteve të përcaktuara në nenin 4 të Kushtetutës dhe parimeve respektive të shtjelluara përmes Aktgjykimeve të Gjykatës. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ky nuk është rasti lidhur me kategorinë e Agjencive të Pavarura të përcaktuara në nenin 142 të Kushtetutës dhe të cilave, Ligji i kontestuar nuk u garanton pavarësinë edhe autonominë e nevojshme kushtetuese, posaçërisht duke marrë parasysh që bazuar në nenin 104 të Ligjit të kontestuar, shfuqizohen edhe të gjitha dispozitat e ligjeve të miratuara nga Kuvendi përkitazi me Agjencitë e Pavarura, e që janë në kundërshtim me Ligjin e kontestuar. Aktgjykimi tutje sqaron se përderisa sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, Agjencitë e Pavarura të themeluara sipas nenit 142 të Kushtetutës, jodetyrimisht gëzojnë nivelin e njëjtë të pavarësisë kushtetuese sikurse institucionet e listuara specifikisht në kapitullin XII të Kushtetutës, megjithatë, bazuar në këtë fundit, është e qartë që të njëjtat nuk i nënshtrohen kontrollit dhe mbikëqyrjes së pushtetit ekzekutiv, por mbikëqyrjes nga Kuvendi, bazuar në ligjet respektive që i njëjti miraton sipas nenit 142 të Kushtetutës. Për më tepër, Aktgjykimi gjithashtu thekson që Ligji i kontestuar statusin e “nëpunësit civil me status të veçantë” e përcakton edhe për një pjesë të vet pushtetit ekzekutiv, përfshirë nëpunësit e vet Ministrisë përgjegjëse për administratën publike, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa përjashtimi nga ky

status i nëpunësve të Agjencive të Pavarura të përcaktuara në nenin 142 të Kushtetutës, nuk rezulton as të ketë ndjekur një qëllim legjitim dhe/ose të jetë proporcional.

Për më tepër dhe përkitazi me çështjen e dytë, Aktgjykimi thekson që kompetenca mbikëqyrëse lidhur me respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, përmes nenit 101 të Kushtetutës, i është përcaktuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës. Pavarësia kushtetuese dhe funksioni i këtij institucioni është shtjelluar nga Gjykata përmes një numri Aktgjykimesh, bazuar në të cilat, ndër tjerash, është sqaruar që pikërisht me qëllimin e sigurimit të një shërbimi civil dhe/ose administrate publike të paanshme, të pavarur dhe profesionale, Kushtetuta ka përcaktuar një institucion kushtetues të veçantë dhe të pavarur nga pushteti ekzekutiv me kompetencën e mbikëqyrjes së rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Aktgjykimi, më tej, sqaron që (i) kompetenca mbikëqyrëse e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, e përcaktuar me Kushtetutë, nuk mund të cenohet dhe as përvetësohet nga pushteti ekzekutiv përmes akteve me hierarki më të ulët të normave, përkatësisht ligjit; për më tepër që (ii) kompetencat mbikëqyrëse të Qeverisë, të saktësuara përmes nenit 12 dhe 13 të Ligjit të kontestuar, janë qartësisht edhe kompetenca të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës bazuar në Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, dhe të cilat cenohen edhe përmes paragrafit 2 të nenit 104 të Ligjit të kontestuar, sipas të cilit çdo dispozitë në kundërshtim me Ligjin e kontestuar shfuqizohet me hyrjen në fuqi të tij. Aktgjykimi sqaron që leximi i përbashkët i neneve 12, 13 dhe 104 të Ligjit të kontestuar, përmes të cilave Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës esencialisht zhvishet nga funksionet kushtetuese, e të cilat përvetësohen nga Qeveria, rezulton në kundërshtim me nenet 4 dhe 101 të Kushtetutës, respektivisht.

- *lidhur me përcaktimin e mandateve të kufizuara për pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike – efekti në të drejta pas hyrjes në fuqi të ligjit të kontestuar*

Në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës për cenimin e parimeve kushtetuese përkitazi me shërbimin civil, ndër tjerash, si rezultat i përcaktimit të mandateve të kufizuara lidhur me pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike, Aktgjykimi fillimisht sqaron që sipas nenit 46 të Ligjit të kontestuar, kategoria e pozitave të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike, do t'i nënshtrohet mandateve

të kufizuara, përkatësisht mandatit katër (4) vjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat të njëjtë, nën kushtet e përcaktuara me ligj. Gjykata, duke shtjelluar dhe marrë parasysh parimet themelore kushtetuese përkitazi me sundimin e ligjit, sigurinë juridike dhe hierarkinë e normave, si dhe kontributin e gjykatave kushtetuese dhe/ose ekuivalentëve përkatëse të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, vlerësimin e saj, në kontekst të kushtetutshmërisë së nenit të lartcekur, në parim, e fokusoi në: (i) karakteristikat kushtetuese të shërbimit civil bazuar në nenin 101 të Kushtetutës; dhe (ii) detyrimet që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në kontekst të shërbimit civil/administratës shtetërore, e cila si marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës, bazuar në paragrafin 2 të nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] të Kushtetutës, ka epërsi ndaj ligjeve në rendin juridik të Republikës së Kosovës.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi sqaron që neni 101 i Kushtetutës, përtej (i) kriterit që shërbimi civil duhet të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës dhe të marrë në konsideratë parimin e barazisë gjinore; dhe (ii) përcaktimit që duhet të formohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil, që siguron zbatimin e normave të shërbimit civil, nuk saktëson më tej çështjen e kategorizimit të zyrtarëve publikë dhe/ose kohëzgjatjen apo kufizimet lidhur me mandatet përkatëse. Aktgjykimi gjithashtu, ndër tjerash, sqaron që përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të ratifikuar nga Kuvendi në vitin 2015, Republika e Kosovës ka marrë përsipër edhe detyrimin e reformimit të administratës shtetërore në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, sipas përcaktimeve të nenit 120 (Administrata publike) të marrëveshjes së lartcekur, i cili, ndër tjerash, i referohet edhe zhvillimit të karrierës në shërbimin publik, por nuk përcakton detyrime dhe/ose specifika në kontekst të kategorizimit të zyrtarëve publikë dhe/ose kohëzgjatjen e mandateve përkatëse. Për më tepër dhe në kontekst të të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike, Aktgjykimi thekson që të gjithë zyrtarët publikë që përzgjedhen/emërohen në pozitën e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike në të ardhmen, përkatësisht pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, do të kenë paraprakisht qartësinë dhe parashikueshmërinë e nevojshme në kontekst të detyrimeve që ndërmarrin dhe të drejtave që fitojnë, përfshirë mandatet e kufizuara në administratën publike.

Thënë këtë, Aktgjykimi gjithashtu sqaron që bazuar në shkresat e dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës, rezulton që Opinioni i Zyrës Ligjore të Bashkimit Evropian dhe SIGMA-s, ndër tjerash, kishte

tërhequr vërejtjen për mangësitë e reformës së administratës publike. Për më tepër, bazuar në kontributet e dorëzuara në Gjykatë përmes Forumit të Komisionit të Venecias, rezulton që përderisa administratat publike të shteteve respektive, përjashtimisht, përcaktojnë pozita me mandate të kufizuara, në parim, asnjë prej tyre nuk ka ndërmarrë një reformë sipas të cilës pozitat me mandate të përhershme janë shndërruar në të përkohshme, duke afektuar edhe të drejtat e fituara të zyrtarëve të administratave respektive shtetërore.

Megjithatë, Aktgjykimi thekson që bazuar në Kushtetutë, Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ, ndërsa Gjykata Kushtetuese është përgjegjëse për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës. Marrë parasysh kompetencat përkatëse të përcaktuara me Kushtetutë dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, kjo e fundit kufizohet vetëm në vlerësimin e përputhshmërisë së aktit të kontestuar me Kushtetutën dhe për aq sa e njëjta nuk është cenuar, nuk vlerëson edhe përshtatshmërinë e politikave publike të përcaktuara nga pushteti ekzekutiv dhe/ose legjislativ dhe të cilat reflektohen në ligjet e miratuara nga përfaqësuesit e popullit në Kuvend. Për pasojë dhe duke marrë parasysh që (i) neni 101 i Kushtetutës dhe neni 120 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nuk përmbajnë detyrime specifike në kontekst të kategorizimit dhe/ose mandateve të zyrtarëve publikë në administratën shtetërore; dhe (ii) përmes këtij neni afektohen zyrtarët publikë që emërohen/përzgjedhen në pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, Gjykata, konstaton që neni 46 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të Kushtetutës.

- *lidhur me efektin e kufizimit të mandateve për zyrtarët që aktualisht ushtrojnë funksione të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues në administratën publike – efekti në të drejtat e fituara para hyrjes në fuqi të ligjit të kontestuar*

Në kontekst të pretendimeve të parashtresve të kërkesës përkitazi me efektet prapavepruese të Ligjit të kontestuar lidhur me zyrtarët që aktualisht mbajnë pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues me mandate me afat të pacaktuar dhe të fituara bazuar në ligjet ekzistuese për shërbimin civil/zyrtarët publikë, për pasojë cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese, Aktgjykimi fillimisht sqaron që neni 99 i Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, përcakton që më së voni një (1) vit nga hyrja në fuqi, të gjitha pozitat e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, do t'i nënshtrohen konkursit të hapur dhe publik. Ligji i kontestuar

përcakton që zyrtarët publikë që aktualisht mbajnë këto pozita, kanë të drejtë aplikimi në këto konkurse dhe në rast të mospërzgjedhjes, (i) do të sistemohen në pozita profesionale për të cilat plotësojnë kushtet, si dhe për periudhën katër (4) vjeçare vijuese, do të përfitojnë nga një pagë tranzitore sipas përcaktimeve të ligjit; ose (ii) do të sistemohen në “Listën e Pritjes” dhe mund të lirohen nga shërbimi civil nëse nuk mund të sistemohen në pozita profesionale. Aktgjykimi sqaron që kjo kategori zyrtarësh të administratës shtetërore janë emëruar në pozitat e ulëta dhe/ose të mesme drejtuese bazuar në ligjet në fuqi për shërbimin civil dhe/ose zyrtarët publikë, mbi bazën e të cilave kanë ndërmarrë detyrime dhe/ose fituar të drejta, përfshirë “pritjet legjitime që mund të rezultojnë në pasuri” bazuar në kontratat përkatëse me afat të pacaktuar, mënyra e ndryshimit dhe/ose ndërprerjes të të cilave, është qartësisht e saktësuar në ligjet e aplikueshme në fuqi. Për pasojë, vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 99 të Ligjit të kontestuar, ngërthen edhe detyrimin e vlerësimit të përputhshmërisë me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, me theks në nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (E drejta në pronë) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në kontekst të të drejtave të garantuara përmes neneve të lartcekura, pas shtjellimit të parimeve të përgjithshme përkitazi me parimin e sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara, përfshirë bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Aktgjykimi sqaron që këto të drejta nuk janë absolute dhe mund t'i nënshtrohen kufizimeve/ndërhyrjes bazuar në nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, vetëm për aq sa kufizimi/ndërhyrja në të drejtën përkatëse është (i) e “përcaktuar me ligj”; (ii) “ndjek një qëllim legjitim”; dhe (iii) është “në proporcion të arsyeshëm me qëllimin që kërkohet të arrihet”.

Aktgjykimi tutje sqaron që në rrethanat e nenit 99 të Ligjit të kontestuar, nuk është kontestuese që ka kufizim/ndërhyrje të të drejtave dhe lirive themelore të zyrtarëve aktualë të administratës shtetërore të cilët ushtrojnë detyra të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, ndër tjerash, sepse zbatimi i këtij neni, mund të rezultojë jo vetëm në humbjen e funksioneve që ushtrojnë, por edhe të marrëdhënies së punës, sepse bazuar në dispozitat e Ligjit të kontestuar (i) kategoria e zyrtarëve të lartcekur, nëse nuk rizgjedhen në pozitat që kanë fituar bazuar në ligjin në fuqi, mund të sistemohen në pozita profesionale me pagë më të ulët ose të vendosen në “Listën e Pritjes”, e cila mund të rezultojë me lirim nga shërbimi civil; (ii) çdo refuzim për t'u sistemuar në pozitën profesionale të ofruar apo edhe refuzimi për t'u vendosur në “Listën e Pritjes”,

rezulton me lirim nga shërbimi civil; për më tepër që (iii) të njëjtit nuk kanë qasje në asnjë mjet efektiv juridik për të kontestuar aktet e autoritetit publik në kontekst të zbatimit të nenit 99 të Ligjit të kontestuar. Thënë këtë dhe duke aplikuar parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së, Aktgjykimi sqaron që nuk është kontestuese që kufizimi/ndërhyrja në të drejtat e fituara (i) është “i përcaktuar me ligj”, përkatësisht i përcaktuar përmes Ligjit të kontestuar; dhe (ii) ndjek “qëllimin legjitim” të reformimit të administratës shtetërore bazuar në parimet e efikasitetit, meritokracisë, gjithpërfshirjes dhe llogaridhënies, por kontestuese është nëse ky kufizim/ndërhyrje në të drejtat dhe liritë themelore përkatëse, është “proporcional në raport me qëllimin e synuar”.

Aktgjykimi, pas aplikimit të parimeve që burojnë nga praktika relevante e GJEDNJ-së, thekson që zgjidhja e përcaktuar përmes nenit 99 të Ligjit të kontestuar, nuk paraqet “ekuilibër të drejtë” mes qëllimit të deklaruar të interesit publik dhe të drejtave dhe lirive themelore, dhe rrjedhimisht nuk është proporcionale, ndër tjerash, sepse (i) qëllimi i njëjtë do të mund të arrihej përmes mekanizmave më pak kufizues/ndërhyrës në të drejtat dhe liritë themelore përmes zbatimit të dispozitave ekzistuese të Ligjit në fuqi për Zyrtarët Publikë, përfshirë edhe dispozitat e detajuara të Ligjit të kontestuar e që ndërlidhen, ndër tjerash, me vlerësimin e performancës dhe/ose masat disiplinore, përfshirë në rast të mos përmbushjes së detyrave të punës; (ii) kategorisë ekzistuese të zyrtarëve të administratës shtetërore që mbajnë pozita të nivelit të ulët ose të mesëm drejtues, në kundërshtim me të drejtat kushtetuese për mjet juridik efektiv dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, respektivisht, u është mohuar në tërësi e drejta në ankesë për sa i përket sistemit në pozitën përkatëse profesionale, futjes në “Listën e Pritjes” ose liritë nga shërbimi civil; dhe se (iii) bazuar në parimin e sigurisë juridike, por edhe në përgjigjet e pranuar nga gjykatat kushtetuese dhe/ose ekuivalentet përkatëse anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, rezulton që një reformë e tillë e administratës publike, ose nuk është ndërmarrë, ose nuk e ka kaluar testin e vlerësimit të kushtetutshmërisë, me përjashtim të sqarimeve të dhëna nga Gjykata Kushtetuese e Austrisë, lidhur me reformën përkatëse e cila është zbatuar gradualisht dhe pa efekt ndaj zyrtarëve që kishin mandate/kontrata të përhershme, duke u mundësuar të njëjtëve që të zgjedhin vet në mes të sistemit të karrierës ose atij të pozitës, me beneficinet përkatëse nëse vullnetarisht pranojnë kalimin në

sistem të pozitës në administratën publike. Për pasojë, Aktgjykimi konstaton që neni 99 i Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

- *lidhur me të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë që vendosen në “Listat e Pritjes” në administratën shtetërore*

Aktgjykimi gjithashtu sqaron që nenet 46 dhe 99 të Ligjit të kontestuar i referohen nenit 67 (Lista e pritjes) të tij, përkitazi me “Listën e Pritjes”. Përderisa Aktgjykimi ka sqaruar që neni 46 i Ligjit të kontestuar, përfshirë konceptin e “Listës së Pritjes”, është zgjidhje e Kuvendit e cila, përjashtimisht efektit të përcaktuar në nenin 99 të Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, Gjykata vëren që përcaktimet e nenit 67 të Ligjit të kontestuar, megjithatë ngritin çështje të të drejtave dhe lirive themelore të zyrtarëve përkatës të vendosur në këtë Listë. Kjo, ndër tjerash, sepse Ligji i kontestuar, në kontekst të “Listës së Pritjes”, përcakton vetëm detyrimet e zyrtarëve përkatës duke mos përcaktuar gjithashtu dhe të drejtat, por duke i deleguar të njëjtat në përcaktimin përmes aktit nënligjor të Ministrisë përgjegjëse për administratë publike. Më saktësisht dhe sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, neni 67 i Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, përcakton që gjatë periudhës deri në nëntë (9) muaj për pritjes para sistemit në një pozitë profesionale dhe/ose liritë nga shërbimi civil, nëpunësit përkatës (i) kanë detyrimin të mos kenë marrëdhënie tjetër pune ose në të kundërtën, humbin të drejtat që mund të burojnë nga “Lista e Pritjes”; përderisa (ii) të drejtat e tyre, përfshirë pagën dhe/ose nivelin e saj, nuk janë të garantuara përmes Ligjit të kontestuar, por sipas të njëjtit, do të përcaktohen me akt nënligjor. Aktgjykimi sqaron që raporti i tillë në mes të të drejtave dhe detyrimeve nuk është proporcional, dhe për më tepër, në kundërshtim me kriteret e “qartësisë” dhe “parashikueshmërisë” lidhur me ligjin e aplikueshëm, të ngërthyera në parimin e sigurisë juridike, sipas interpretimit të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të Gjykatës dhe opinioneve relevante të Komisionit të Venecias.

- *lidhur me të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë që vendosen në “Listat e Pritjes” në administratën shtetërore*

Në kontekst të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës përkitazi me kriterin e “përshtatshmërisë”, mbi bazën e të cilit mund të pranohen në detyrë zyrtarët publikë në administratën shtetërore, dhe i cili sipas pretendimit, cenon parimin e sigurisë juridike dhe ndër tjerash, ka pasojën e ndërhyrjeve politike në

politikat e rekrutimit në administratën publike, Aktgjykimi fillimisht sqaron që neni 9 i Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, përcakton kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë të zyrtarëve publikë, duke shtuar gjithashtu kriterin e “përshtatshmërisë” për emërim në pozita specifike të zyrtarëve publikë, saktësimi/definimi i të cilit, sipas nenit përkatës, delegohet në nivel të aktit nënligjor, të miratuar nga Qeveria me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për administratë publike. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së kësaj dispozite, Aktgjykimi shtjellon (i) parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, praktika e Gjykatës dhe Lista Kontrolluese e Sundimit të Ligjit e Komisionit të Venecias, lidhur me parimin e sigurisë juridike, të mishëruar në konceptin e sundimit të ligjit, e të garantuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës, respektivisht; dhe (ii) kontributet e gjykatave kushtetuese dhe/ose ekuivalentëve të shteteve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias.

Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që ndër kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 të nenit 9 të Ligjit të kontestuar, janë edhe “aftësia për të kryer detyrën përkatëse” dhe “arsimi, përvoja e punës profesionale dhe/apo aftësia e kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës”, duke i lënë autoritetit publik diskrecion të gjerë vlerësimi në pranimin në detyrë të zyrtarit publik. Thënë këtë, këto kriterë, përfshirë ato objektive të saktësuara në të njëjtin paragraf, mund të mbizotërohen në tërësinë e tyre, përmes një kriteri të “përshtatshmërisë”, të saktësuar përmes një akti nënligjor, mbi bazën e të cilit diskrecioni i autoritetit publik është në disproporcion me parimin e “qartësisë” dhe “parashikueshmërinë” së nevojshme në kontekst të ligjit të aplikueshëm, përfshirë lidhur me procedurën e aplikimit dhe të së drejtës pasuese për përdorimin e mjetit juridik të kandidatëve, në një administratë shtetërore, e cila sipas Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, është përcaktuar të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë, meritës, transparencës, profesionalizimit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit. Për pasojë, dhe marrë parasysh parimet e shtjelluara lidhur me sigurinë juridike, përfshirë detyrimin që dispozitat relevante të ligjit të jenë “të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme”, Gjykata ka vlerësuar që përcaktimi i kriterit të “përshtatshmërisë” është i papajtueshëm me garancitë kushtetuese sipas sqarimeve të dhëna në dispozitivin e Aktgjykimit.

- *lidhur me të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë që vendosen në “Listat e Pritjes” në administratën shtetërore*

Aktgjykimi vë theks në faktin që e drejta në mjet

juridik dhe e drejta në mbrojtje gjyqësore të të drejtave, të përcaktuara në nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje edhe me nenin 13 (E drejta në mjet efektiv juridik) të KEDNJ-së, përbëjnë ndër të drejtat më themelore të individëve, përfshirë në kontekst të parimit të qasjes në drejtësi, të përcaktuar përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta në gjykim të drejtë) të KEDNJ-së. Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që këto të drejta janë cenuar në tërësinë e tyre në kontekst të nenit 99 të Ligjit të kontestuar. Thënë këtë, Aktgjykimi gjithashtu vë theks në faktin që neni 27 (E drejta për informim për marrëdhënien e punës dhe e drejta e ankesës) i Ligjit të kontestuar në ndërlidhje me nenin 88 (E drejta për ankesë e nëpunës/it të shërbimit publik) të tij, gjithashtu ngritin çështje serioze kushtetuese në kontekst të të drejtave të lartcekura. Kjo së pari sepse, përderisa të drejtat e nëpunësit civil për të paraqitur ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe më pas, në gjykatën kompetente, janë përcaktuar, këto të drejta janë kushtëzuar vetëm “në rastet e parapara sipas këtij ligji”. Aktgjykimi, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sqaron që e drejta në mjet juridik efektiv ndaj cilitdo akt të autoritetit publik që mund të ketë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit të përcaktuara me ligj dhe/ose Kushtetutë, në parim, nuk mund të kufizohet. Së dyti, Aktgjykimi gjithashtu sqaron që bazuar në nenet 27 dhe 88 të Ligjit të kontestuar, është përcaktuar e drejta e nëpunësit publik për ankesë, përkatësisht mjet juridik, në Inspektoratin e Punës dhe më pas, në gjykatën kompetente. Aktgjykimi thekson që një përcaktim i tillë ligjor është në kundërshtim të plotë me Ligjin e Punës dhe vet Ligjin për Inspektoratin e Punës, i cili nuk i përcakton të njëjtit kompetencën për të zgjidhur konteste nga marrëdhënia e punës dhe për më tepër, me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve të përcaktuar në nenin 4 të Kushtetutës, ndër tjerash, sepse (i) Inspektorati i Punës, bazuar në ligjin për themelimin e tij, është autoritet ekzekutiv që themelohet nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe rrjedhimisht, është pjesë përbërëse e pushtetit ekzekutiv; dhe (ii) në rendin juridik të Republikës së Kosovës, i cili bazohet në vlerat dhe parimet e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, është pushteti gjyqësor dhe jo ai ekzekutiv, që ka kompetencën për të vendosur në lidhje me kontestet lidhur me të drejta dhe detyrime, përfshirë ato që burojnë nga marrëdhënia e punës. Të gjitha këto parime tashmë janë sqaruar përmes Aktgjykimit në rastin KO27/21, të publikuar më 16 dhjetor 2022, nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.



Aktgjykim

KO 177/23

Parashtrues

Komuna e Prizrenit

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit të lartcekur është parashtruar në Gjykatë nga Komuna e Prizrenit, bazuar në autorizimet e përcaktuara përmes paragrafit 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata ka vendosur që (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) neni 5 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafin 1 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 2 dhe 5 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës; (iii) të shfuqizojë Vendimin për Masë të Përkohshme të 1 shtatorit 2023, meqenëse Gjykata tashmë ka vendosur lidhur me meritat e rastit; si dhe që (iv) afati i mbetur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga afati tridhjetë (30) ditë i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 11/B (Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme) të nenit 5 të Ligjit të kontestuar, fillon të rrjedhë nga dita e hyrjes në fuqi të Aktgjykimit.

Aktgjykimi i Gjykatës fillimisht sqaron që bazuar në paragrafin 4 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve të Kuvendit ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt. Bazuar në këtë dispozitë, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Komuna e Prizrenit, kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së

nenit 5 të Ligjit nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Ky nen përcakton që (i) çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023, kualifikohet për faljen e tatimit; (ii) shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro; (iii) vendimi për faljen e tatimit në pronë merret nga kuvendi komunal i çdo komune më së largu tridhjetë (30) ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji; (iv) në rast që tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese; (v) zbatimi i kësaj dispozite mbetet në përgjegjësinë e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë, për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës përkatëse; dhe që (iv) Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e kësaj dispozite.

Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës pretendoi se, dispozita e lartcekur cenon përgjegjësitë komunale dhe zvogëlon të hyrat e komunës në kundërshtim me (i) garancitë kushtetuese të përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 12 [Pushteti Lokal], paragrafët 1 dhe 3 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 2, 3 dhe 5 të nenit 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës; (ii) Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale; dhe (iii) Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjin 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, në esencë dhe ndër tjerash sepse, ndërhyjnë në ushtrimin e kompetencave vetanake të komunës përkitazi me të hyrat nga tatimi në pronën e paluajtshme dhe afekton buxhetin komunal deri në vlerën prej tre (3) milionë euro, ndërsa në nivel të pushtetit lokal në Republikën e Kosovës, deri në vlerën prej njëzet e shtatë (27) milionë euro, sipas të dhënave të referuara të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte kërkuar nga Gjykata që deri në vendosjen meritore të saj lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 5 të Ligjit të kontestuar, të vendosë masën e përkohshme, duke pezulluar efektet e tij. Lidhur me këtë të fundit, më 1 shtator 2023, Gjykata, vendosi për (i) miratimin e kërkesës për masë të përkohshme, në kohëzgjatje deri më 30 nëntor 2023; dhe (ii) pezullimin e zbatimit të nenit 5 të Ligjit nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe zbatimin e vendimeve të nxjerra në bazë të këtij neni, deri në afatin e lartpërmendur. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi

fillimisht shtjellon parimet e përgjithshme lidhur me vetëqeverisjen lokale sipas Kushtetutës, Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale dhe ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë kontekst, Aktgjykimi, duke u bazuar në nenet 12 [Pushteti Lokal], 123 [Parimet e Përgjithshme] dhe 124 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale] të Kushtetutës, Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe ligjet relevante të aplikueshme, ndër tjerash, thekson që nuk është kontestuese që bazuar në Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, çështjet që ndërlidhen me tatimin në pronën e paluajtshme janë kompetencë vetanake e komunave dhe që të njëjtat kanë kompetencën që të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat që burojnë nga tatimi në pronën e paluajtshme sipas përcaktimeve të ligjit të aplikueshëm. Ky i fundit, bazuar në dispozitat e Kushtetutës, përcakton kufijtë e ndarjes së kompetencave në mes pushtetit qendror dhe lokal.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Ligji i kontestuar, (i) përcakton bazën ligjore sipas të cilës mund të falet tatimi në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023, duke saktësuar lartësinë maksimale të faljes së këtij tatimi dhe afatin përkatës kohor brenda të cilit mund të merret vendimi për faljen e tatimit në pronën e paluajtshme; dhe (ii) kompetencën për një vendimmarrje të tillë ia përcakton kuvendeve përkatëse komunale. Në interpretimin e dispozitave të kontestuara në tërësinë e tyre dhe në kontekst të garancive të përcaktuara me Kushtetutë lidhur me vetëqeverisjen lokale, Aktgjykimi sqaron që Ligji i kontestuar nuk detyron kuvendet komunale përkatëse, por saktëson bazën ligjore sipas të cilës u mundëson të njëjtave për të vendosur përkitazi me faljen e tatimit në pronën e paluajtshme sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar. Si i tillë, ky i fundit, nuk cenon përgjegjësitë komunale apo nuk zvogëlon të hyrat e komunës në kundërshtim me garancitë kushtetuese dhe legjislationin e aplikueshëm në kontekst të ushtrimit të kompetencave të komunës për të caktuar, mbledhur dhe shpenzuar tatimin në pronën e paluajtshme brenda territorit të komunës përkatëse.

Aktgjykimi më tej gjithashtu thekson që bazuar paragrafin 2 të nenit 123 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, “vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme” dhe se për pasojë, anëtarët e kuvendeve komunale, nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues gjatë vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj. Zbatimi i nenit 5 të Ligjit të

të kontestuar, përkitazi me mundësinë e vendimmarrjes për faljen e tatimit në pronën e paluajtshme sipas kufizimeve dhe afateve kohore të saktësuara në të njëjtin, është në diskrecion dhe kompetencë të plotë të kuvendeve përkatëse komunale.

Aktgjykimi në fund sqaron që (i) marrë parasysh faktin që Ligji i kontestuar ka hyrë në fuqi më 16 gusht 2023, ndërsa rrjedhja e afatit tridhjetë (30) ditor i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 11/B (Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme) të Ligjit të kontestuar është ndërprerë me 1 shtator 2023 me vendosjen e masës së përkohshme nga Gjykata, e cila e ka pezulluar zbatimin e nenit 5 të Ligjit të kontestuar deri në vendimmarrjen meritore të saj; (ii) pjesa e mbetur e afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor të saktësuar në nenin e lartcekur, fillon të rrjedhë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, përkatësisht me publikimin e tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ç’rast shfuqizohet edhe Vendimi për Masë të Përkohshme.

Aktgjykimi tutje sqaron që në rast të ushtrimit të diskrecionit të përcaktuar përmes nenit 5 të Ligjit të kontestuar nga kuvendet komunale lidhur me faljen e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023, vet neni 5 i Ligjit të kontestuar përcakton zgjidhjen për qytetarët të cilët tashmë kanë paguar tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023, duke saktësuar në paragrafin 6 të nenit 11/B (Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme) të tij, që “në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese”.



Aktgjykim

KO 173/22

Parashtrues

Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të
Kuvendit të Republikës së Kosovës

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit
Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të
Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të
Destabilizimit në Treg*

Gjykata ka vendosur (i) njëzëri të shpallë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë, me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër, se paragrafët 2 dhe 4 të nenit 4 (Produktet Themelore), paragrafi 2 i nenit 5 (Masat e përkohshme mbrojtëse), paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 9 të nenit 8 (Vendimmarrja) dhe paragrafi 2 i nenit 9 (Mbikëqyrja dhe sanksionet) të Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia] dhe paragrafin 5 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (iii) të konstatojë, me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër, se neni 10 (Hyrja në fuqi) i Ligjit nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat] dhe paragrafin 1 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (iv) të shpallë të pavlefshëm, me shtatë (7) vota për dhe një (1) kundër, në tërësinë e tij, Ligjin nr. 08/L-179 për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg; dhe (iv) të refuzojë, njëzëri, kërkesën për masën e përkohshme.

Aktgjykimi fillimisht sqaron që, Ligji i kontestuar rregullon caktimin e masave të përkohshme mbrojtëse të furnizimit me produkte themelore për konsumatorët, në kohë të paraqitjes së rasteve të veçanta të destabilizimit në treg dhe mënyrën e

zbatimit të tyre ndaj autoriteteve dhe operatorëve ekonomik, në mënyrë që të eliminohen efektet e rritjes së çmimeve si dhe mungesës së produkteve themelore në treg. I njëjti, ndër tjerash, përcakton shkaqet në kuadër të të cilave mund të vendosen masat e përkohshme mbrojtëse. Këto të fundit, përfshijnë (i) kufizimin e sasisë që i shitet konsumatorit brenda periudhës së caktuar; (ii) ndalimin e largimit nga shitja e produktit; (iii) caktimin e marzhës tregtare për shitjen me shumicë dhe pakicë; (iv) caktimin e çmimit maksimal të lejuar; (v) detyrimin e operatorit ekonomik për të ruajtur pjesën e caktuar të stokut të produktit; (vi) detyrimin e operatorit ekonomik për t'u furnizuar dhe për të ofruar për shitje produkte themelore si para caktimit të masave mbrojtëse; dhe (vii) ndalimin, kufizimin e eksportit. Sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar, ndër tjerash, masat mund të vendosen në përpjesëtim me nevojën për mbrojtjen e konsumatorit dhe duhet të jenë në përputhje me zotimet dypalëshe të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Ligji i kontestuar, gjithashtu dhe ndër tjerash, përcakton themelimin e një Komisioni që ofron rekomandime Ministrisë përkatës lidhur me përcaktimin dhe kohëzgjatjen e masave të përkohshme mbrojtëse dhe i mundëson të njëjtit që të këshillohet me autoritetet relevante publike në këtë kontekst, përfshirë Këshillin e MSA-së, ndërsa Kryeministrit i përcakton kompetencën që të shfuqizojë, të anulojë ose të ndryshojë çdo vendim të Ministrisë për vendosjen e masave të përkohshme mbrojtëse ndaj operatorëve ekonomik, përkatësisht personave juridik/fizik në rrethana të destabilizimit të tregut.

Parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretenduan se Ligji i kontestuar përbën ndërhyrje në ekonominë e lirë të tregut të garantuar me nenet 7 [Vlerat], 10 [Ekonomia] dhe 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës. Në këtë kontekst, ndër tjerash, të njëjtit theksojnë që bazuar në Kushtetutë, ekonomia e lirë e tregut është vlerë e Republikës së Kosovës dhe që kjo e fundit është e detyruar që të sigurojë një mjedis të favorshëm juridik për ekonominë e tregut, lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe sigurinë e pronës publike dhe private, përfshirë të vendos të gjithë mekanizmat e nevojshëm institucional dhe ligjor për të garantuar që në Kosovë të ketë një treg të hapur, “ku oferta dhe kërkesa përmbajnë modelin e qarkullimit të mallrave, punës, dijes dhe kapitalit në ekonomi” dhe ku operatorët ekonomikë privatë janë të mbrojtur nga një sistem ligjor i mjaftueshëm për të operuar lirisht në tregun e brendshëm. Parashtruesit e kërkesës, ndër tjerash dhe më tej theksuan që, shteti duhet të përmbahet nga ndërhyrja në ekonominë e tregut, përmes çfarëdo

mase e cila kufizon lirinë e operatorëve ekonomik që tregtojnë produkte themelore, duke theksuar gjithashtu që (i) sipas Kushtetutës, shteti mund të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut, atëherë kur ky i fundit, nuk mund që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik; dhe (ii) detyrimi i operatorëve ekonomik, përmes vendimeve të Qeverisë, që të mbajnë rezerva/stoqe të mallrave të caktuara, është arbitrar sepse një qasje e tillë është në kundërshtim edhe me përcaktimet e Ligjit nr. 03/L-244 për Rezervat Shtetërore të Mallrave. Pretendimet e parashtresve të kërkesës kundërshtohen nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje!. Të njëjtit, ndër tjerash, argumentojnë që Ligji i kontestuar (i) nuk është në kundërshtim me parimet kushtetuese të lirisë së ekonomisë së tregut, sepse Kushtetuta mundëson veprimin, përkatësisht ndërhyrjen e shtetit në rregullimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike përmes ligjeve të Kuvendit, dhe që në rrethanat e rastit konkret, Ligji i kontestuar ndjek qëllimin legjitim të mbrojtjes së interesit publik, përkatësisht mbrojtjes së konsumatorit në rrethana të veçanta të destabilizimit të tregut dhe gjithashtu që masat e përcaktuara përmes Ligjit të kontestuar, janë proporcionale me qëllimin e ndjekur; dhe (ii) nuk është në kundërshtim me detyrimet e Republikës së Kosovës që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Gjykata, në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, fillimisht shtjelloi (i) parimet themelore të ekonomisë së lirë të tregut sipas Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës; (ii) parimet relevante që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare dhe që ndërlidhen me ekonominë e lirë të tregut dhe rrethanat në të cilat ndërhyrja përkatëse e shtetit mund të jetë kompatible me lirinë e ekonomisë së tregut, siç janë të përcaktuara përmes rregullativës së aplikueshme të Bashkimit Evropian dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, por edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias dhe kontributit të Gjykatave Kushtetuese dhe/ose ekuivalentëve të tyre të Forumit të Komisionit të Venecias; dhe më pas (iii) aplikoi këto parime përgjatë vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar. Aktgjykimi, në dritën e argumenteve dhe kundër-argumenteve të prezantuara, ndër tjerash, shqyrton dhe vlerëson (i) nëse masat e përkohshme mbrojtëse të përcaktuara përmes Ligjit të kontestuar përbëjnë ndërhyrje në ekonominë e lirë të tregut; (ii) nëse mekanizmat vendimmarrës përkitazi me vendosjen e masave të përkohshme mbrojtëse të përcaktuara

përmes Ligjit të kontestuar janë në përputhshmëri me Kushtetutën; dhe (iii) nëse Ligji i kontestuar është në pajtueshmëri me parimin e sigurisë juridike, përkatësisht sundimin e ligjit si vlerë thelbësore e Republikës së Kosovës.

(i) nëse Ligji i kontestuar cenon parimet kushtetuese të ekonomisë së lirë të tregut

Aktgjykimi vë theks në faktin që (i) bazuar në nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, ekonomia e tregut është vlerë e Republikës së Kosovës; (ii) bazuar në nenin 10 [Ekonomia] të Kushtetutës, ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës; dhe (iii) bazuar në nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, ndër tjerash, është detyrë e autoriteteve shtetërore që të sigurojnë një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private, dhe gjithashtu që të mbrojnë konsumatorin në pajtim me ligjin. Aktgjykimi, më tej, sqaron që (i) veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen “në mënyrë eksplicite” me ligj; ndërsa (ii) Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik. Për më tepër, Aktgjykimi thekson që operatorët ekonomik ndaj të cilëve aplikohen masat e përkohshme mbrojtëse të saktësuara përmes Ligjit të kontestuar, janë edhe persona juridik dhe ndaj tyre, bazuar në nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës vlejnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të saktësuara në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, për aq sa janë të zbatueshme dhe rrjedhimisht, mund të kufizohen vetëm sipas përcaktimeve të nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, përkatësisht për aq sa kufizimi përkatës është “i përcaktuar në ligj”, “ndjek një qëllim legjitim” dhe është “proporcional me qëllimin e ndjekur”.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka të drejtën por edhe detyrën që të miratojë legjislacionin e duhur për të siguruar mjedisin e favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, por edhe mbrojtjen e konsumatorit, përfshirë mundësinë që (i) “në mënyrë eksplicite” të përcaktojë përjashtimet nga konkurrenca e lirë; dhe (ii) të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik. Detyrime në

kontekst të ekonomisë së lirë të tregut burojnë edhe nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, e cila bazuar në nenet 16 [Epërsia e Kushtetutës] dhe 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] të Kushtetutës, është pjesë e sistemit të brendshëm juridik dhe ka epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Në parim dhe në kontekst të emëruesit të përbashkët që buron nga vendimet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe kontributit të Gjykatave Kushtetuese dhe/ose ekuivalentëve përkatëse anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, nuk është kontestuese që masat e përkohshme mbrojtëse në kontekst të importit, eksportit, përfshirë rrethanave të destabilizimit të tregut, mund të jenë të mundshme, për aq sa të njëjtat janë të “përcaktuara me ligj”, ndjekin një “qëllim legjitim” dhe janë rreptësisht “proporcionale”. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, ndërhyrjet e tilla në lirinë e ekonomisë së tregut duhet të jenë në mënyrë shprehimore të domosdoshme dhe nuk mund të përbëjnë në asnjë rrethanë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë e lirë. Për më tepër, sipas shtjellimeve të detajuara në Aktgjykim, legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës gjithashtu përmban dispozita dhe përcaktime për rregullimin e masave të përkohshme mbrojtëse apo masave kufizuese të përkohshme, si në kontekst të tregtisë së brendshme ashtu edhe asaj të jashtme.

Në kontekstin e Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi sqaron që, në parim, qëllimi dhe fushëveprimi i Ligjit të kontestuar, përfshirë përcaktimin e listës së produkteve themelore dhe masave të përkohshme mbrojtëse që mund të vendosen në operatorët ekonomik, në rrethana të veçanta të destabilizimit të tregut, për aq sa ndjekin një qëllim legjitim dhe janë rreptësisht proporcionale me qëllimin e ndjekur, nuk përbëjnë ndërhyrje arbitrare në ekonominë e lirë të tregut. Për më tepër, masat e përkohshme mbrojtëse ndaj operatorëve ekonomik, përkatësisht personave juridik/fizik, i nënshtrohen edhe të drejtës të ushtrimit të mjetit juridik dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të operatorëve ekonomik të garantuara përmes neneve 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht, korniza ligjore që mundëson ndërhyrjen e shtetit në ekonominë e lirë të tregut në rrethana të veçanta të destabilizimit të tregut, nuk nënkupton edhe ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e masave të përkohshme mbrojtëse, të cilat mund të i nënshtrohen vlerësimit të ligjshmërisë nga gjykatat e rregullta dhe kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese sipas përcaktimeve të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.

Për pasojë dhe bazuar në sqarimet e dhëna në Aktgjykim, Gjykata vlerësoi që neni 1 (Qëllimi), neni 2 (Fushëveprimi), neni 3 (Përkufizime), paragrafët 1, 3 dhe 5 të nenit 4 (Produktet Themelore), paragrafët 1 dhe 3 të nenit 5 (Masat e përkohshme mbrojtëse), neni 6 (Shkaqet dhe kohëzgjatja e masave mbrojtëse), neni 7 (Llogaritja e Marzhës), paragrafët 7 dhe 8 të nenit 8 (Vendimmarrja) dhe paragrafët 1, 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 9 (Mbikëqyrja dhe sanksionet) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia] dhe paragrafin 3 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

Thënë këtë, përmbajtja e Ligjit të kontestuar ngërthen edhe dy çështje kushtetuese, përkatësisht (i) detyrimin kushtetues të Republikës së Kosovës të përcaktuar sipas paragrafit 5 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, sipas të cilit, atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik, Republika e Kosovës do të themelojë “organe të pavarura” për rregullimin e tregut; dhe (ii) parimin e sigurisë juridike, si pjesë thelbësore e sundimit të ligjit të mishëruar në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës sipas paragrafit 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, gjetjet përkitazi me të cilat janë të përmbledhura si në vijim:

(ii) nëse mekanizmat vendimmarrës përkitazi me vendosjen e masave të përkohshme mbrojtëse janë në përputhshmëri me garancitë kushtetuese

Aktgjykimi sqaron që Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në paragrafin 5 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të saj, qartësisht përcakton detyrimin e shtetit që të themelojë “organe të pavarura për rregullimin e tregut” në mbrojtje të interesit publik, atëherë kur vetë tregu nuk mund të bëjë një gjë të tillë. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, rrethanat e përcaktuara përmes Ligjit të kontestuar, në të cilat liria e veprimtarisë ekonomike të operatorëve ekonomik mund të kufizohet përmes masave të përkohshme mbrojtëse, përkatësisht (i) mungesa e papritur apo të vazhdueshme të produkteve themelore; (ii) ngritja e papritur apo e menjëhershme e çmimeve të produkteve themelore; (iii) mospërshtatja e çmimeve vendore me lëvizje të mëdha të çmimeve në tregun botëror; dhe (iv) dallimi i pajustificueshëm i çmimeve vendore nga çmimet në vendet fqinje, përfshijnë rrethana në të cilat tregu jodetyrimisht mund të rregullojë vetveten pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe të cilat, bazuar në Kushtetutën e Republikën e Kosovës, duhet të jenë “organe të pavarura”. Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të

Pavarura, për qëllime të rregullimit dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së operatorëve të një tregu të caktuar me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve dhe sigurimit të konkurrencës së lirë, u referohet agjencive të pavarura rregullatore. Një zgjidhje e tillë është në përputhje edhe me përcaktimin e ekonomisë së lirë të tregut, si vlerë thelbësore e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës sipas neneve 7 [Vlerat] dhe 10 [Ekonomia] të Kushtetutës.

Bazuar në kontributin e Forumit të Komisionit të Venecias dhe analizës krahasimore të shtjelluar në Aktgjykim, varësisht nga rendet përkatëse kushtetuese, shtetet kanë përcaktuar mekanizma të ndryshëm për zbatimin e masave kufizuese/mbrojtëse në rrethana të destabilizimit të tregut, përfshirë pushtetin ekzekutiv, rregullatorë/organe të pavarura apo edhe komisione të veçanta. Pavarësia e mekanizmave vendimmarrës në kontekst të kufizimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike të operatorëve ekonomik në rrethana të destabilizimit të tregut, është saktësuar edhe në aktet që i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, përkundër faktit që për dallim nga Kushtetuta e Kosovës, ajo e Shqipërisë nuk përmban detyrimin kushtetues të themelimit të “organeve të pavarura” për këtë qëllim. Përmes dy Aktgjykimeve përkatëse, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, ka shfuqizuar në tërësi dhe pjesërisht si në kundërshtim me Kushtetutën aktet e kontestuara.

Në rrethanat e Ligjit të kontestuar, përderisa është përcaktuar (i) themelimi i një Komisioni i cili i rekomandon Ministrit ndërmarrjen dhe kohëzgjatjen e masave të përkohshme mbrojtëse; (ii) mundësia e këshillimit të Ministrit me autoritetet relevante publike për qëllim të vendosjes së masave të përkohshme mbrojtëse; dhe (iii) roli i Këshillit të MSA-së, i cili vetëm konsultohet dhe/ose njoftohet para marrjes së vendimeve për masat e përkohshme mbrojtëse, asnjë nga këto mekanizma nuk e detyrojnë Ministrin përkatës, vendimmarrja e të cilit në përcaktimin e masave të përkohshme mbrojtëse lidhur me operatorët ekonomik, përkatësisht personat juridik/fizik, është e plotë dhe ekskluzive, për më tepër që, Kryeministri, mund të shfuqizojë, të anulojë ose të ndryshojë çdo vendim të Ministrit në këtë kontekst.

Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, përderisa kompetencat kushtetuese të Qeverisë dhe/ose Kryeministrit në nxjerrjen e vendimeve në zbatim të ligjeve të Republikës së Kosovës, përfshirë në kontekst të zhvillimit ekonomik nuk janë kontestuese, marrë parasysh që paragrafi 5 i nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës saktësisht përcakton që Republika e Kosovës do të themelojë “organe të pavarura” për rregullimin e tregut atëherë kur vetë

tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik, dhe i cili bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian përfshinë edhe mbrojtjen e konsumatorit, kompetenca e Ministrit dhe/ose Kryeministrit për të vendosur masa të përkohshme mbrojtëse dhe të cilat kufizojnë lirinë e veprimtarisë ekonomike të operatorëve ekonomikë në Republikën e Kosovës, nuk përkon me standardin kushtetues të vendimmarrjes së pavarur lidhur me rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi që paragrafët 2 dhe 4 të nenit 4 (Produktet Themelore), paragrafi 2 i nenit 5 (Masat e përkohshme mbrojtëse), paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 9 të nenit 8 (Vendimmarrja) dhe paragrafi 2 i nenit 9 (Mbikëqyrja dhe Sanksionet) të Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], nenin 10 [Ekonomia] dhe paragrafin 5 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

(iii) nëse Ligji i kontestuar është në përputhshmëri me parimin e sigurisë juridike

Aktgjykimi sqaron që, Ligji i kontestuar përcakton që i njëjti hyn në fuqi me publikimin e tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Thënë këtë, rrethanat që rregullon i njëjti, përkatësisht ndërhyrjen e shtetit në ekonominë e lirë të tregut përmes masave të përkohshme mbrojtëse në rrethana të destabilizimit të tregut, i rregullojnë të paktën edhe dy ligje tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht (i) Ligji nr. 03/L-244 për Rezervat Shtetërore të Mallrave; dhe (ii) Ligji nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme ndërlidhur me Ligjin nr. 04/L-005 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme. Ligji i kontestuar nuk amendamenton dhe as nuk shfuqizon dispozitat relevante të asnjërit nga dy ligjet e lartcekura.

Sipas shtjellimeve të Aktgjykimit, në rrethana të tilla, (i) “në rast të çrregullimit të tregut”, përgjegjëse për të ndërhyrë në treg në mbrojtje të popullsisë dhe/ose konsumatorit, është Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes dy ligjeve të ndryshme, përkatësisht Ligjit për Rezervat Shtetërore dhe Ligjit të kontestuar, dhe të njëjtit nuk përcaktojnë qartësisht ndarjen e barrës në mes personit juridik/fizik, përkatësisht operatorit ekonomik dhe autoritetit publik, përkatësisht shtetit në raste të destabilizimit/çrregullimit të tregut, duke e lënë një përcaktim të tillë në diskrecionin e plotë të Ministrisë së lartcekur; për më tepër që (ii) Ligji për Tregtinë e Brendshme, gjithashtu përcakton masa të përkohshme mbrojtëse dhe sanksione për personat juridik/fizik/operatorët



ekonomik në rrethana të destabilizimit/çrregullimit të tregut, dhe të cilat mbesin paralelisht të aplikueshme me masat e përkohshme mbrojtëse të përcaktuara përmes Ligjit të kontestuar.

Rrethanat në të cilat për qëllime të rregullimit të tregut në raste të destabilizimit/çrregullimit të tij, do të ishin të aplikueshme dy ligje të ndryshme, përkatësisht Ligji i kontestuar dhe dispozitat respektive të Ligjit për Tregtinë e Brendshme, të cilat përcaktojnë mundësinë e ndërhyrjes së shtetit në ekonominë e lirë të tregut, përmes mekanizmave, masave dhe sanksioneve paralele, nuk i shërbejnë parimit të sigurisë juridike dhe u pamundësojnë personave juridik/fizik, përkatësisht operatorëve ekonomik, që të rregullojnë sjelljen e tyre konform ligjit të aplikueshëm në kuadër të një ekonomie të tregut me konkurrencë të lirë, që është bazë e rregullimit ekonomik dhe vlerë e Republikës së Kosovës. Aktgjykimi vë theks në faktin që, një ndër parimet më esenciale të sundimit të ligjit si vlerë e Republikës së Kosovës, është parimi i sigurisë juridike dhe i njëjti, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, por edhe të Gjykatës, kërkon, në mes tjerash, që rregullat/ligjet e aplikueshme të jenë të qarta dhe të sakta dhe të synojnë të sigurojnë që situatat dhe marrëdhëniet juridike të mbeten të parashikueshme dhe që për këtë qëllim, normat ligjore duhet të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme. Autoritetet publike, gjatë hartimit të ligjeve duhet të marrin parasysh edhe këto parime bazë të sundimit të ligjit, si pjesë të rëndësishme të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, Gjykata gjithashtu konstatoi që neni 10 (Hyrja në fuqi) i Ligjit të kontestuar, nuk është në përputhshmëri me parimin e sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit, të garantuara përmes paragrafit 1 të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës.

Në fund, Aktgjykimi sqaron që kërkesa e parashtruesve të kërkesës është parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe se kjo kategori e kërkesave ka karakter suspenziv, përkatësisht ligji i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës për rastin e kontestuar. Në kontekst të praktikës së saj gjyqësore, siç është shtjelluar edhe në Aktgjykim, Gjykata vlerëson që marrë parasysh natyrën e dispozitave të Ligjit të kontestuar të shpallura në kundërshtim me Kushtetutën dhe faktin

që pjesa tjetër e Ligjit të kontestuar do të ishte vështirë e zbatueshme pas shpalljes së dispozitave të lartcekura si të pavlefshme, Ligji i kontestuar, në shërbim të parimit të sigurisë juridike, duhet të shpallet i pavlefshëm në tërësinë e tij.



GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 korrik – 31 dhjetor 2023)

* **Ndërhyrja disproporcionale në lirinë e shprehjes së një gjyqtareje të ndëshkuar për zbulimin e parakohshëm të arsyeve të mendimit të saj mospajtues (18/07/2023)**

Në vendimin e Dhomës në çështjen **Manole kundër Republikës së Moldavisë** (kërkesa nr. 26360/19), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me shkarkimin e parashtrueses së kërkesës nga detyra e saj si gjyqtare për shkak se kishte informuar shtypin për arsyet e mendimit të saj mospajtues – ekzistenca e të cilit dihej tashmë – para publikimit të tekstit të plotë të vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit në një rast që ajo kishte gjykuar. Gjykata specifikoi se detyra e diskrecionit të gjyqtarëve u kërkon atyre që të mos zbulojnë arsyet e vendimit para se ato arsye të jenë në dispozicion të publikut. Megjithatë, ajo përsëriti se masat mbrojtëse procedurale dhe natyra dhe ashpërsia e dënimit të shqiptuar ishin kriteret të mëtejshme për t'u shqyrtuar gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes në ushtrimin e lirisë së shprehjes, siç garantohet me nenin 10 të Konventës. Në lidhje me masat mbrojtëse procedurale, Gjykata shprehu rezerva në lidhje me zgjedhjen që i lihet Komisionit Kombëtar të Shërbimit Gjyqësor dhe Ligjor (CSM) për llojin e procedurës administrative që do të përdoret në rastin e parashtrueses së kërkesës. Ajo gjithashtu vuri në dukje se Gjykata e Lartë nuk kishte trajtuar bazën e apelit të parashtrueses së kërkesës në lidhje me moszbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 947/1996 për CSM-në. Ai legjislacion i referohej, në kontekstin e sanksioneve të mundshme administrative për shkelje të ndalimit të zbulimit të informacionit, procedurës disiplinore e cila përfshinte masa mbrojtëse procedurale. Për sa i përket sanksionit të shqiptuar, Gjykata vërejti se shkarkimi i parashtrueses së kërkesës kishte qenë i vetmi sanksion që mund të zbatohet në kohën në fjalë. Ky ishte një ndëshkim shumë i rëndë që i kishte dhënë fund karrierës së saj pas 18 viteve shërbimi të suksesshëm. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se në kohën kur Gjykata e Lartë shqyrtoi ankesën e parashtrueses së kërkesës, Ligji nr. 544/1995 (për statusin e gjyqtarit), mbi bazën e të cilit ishte shqiptuar sanksioni ndaj parashtrueses së kërkesës, ishte ndryshuar së fundi në mënyrë që shkeljet e ndalimit të zbulimit të informacionit nga gjyqtarët nuk ishin më as të dënueshme në atë ligj bazë. Në të njëjtën kohë, Ligji

nr. 178/2014 (për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve), të cilin parashtruesja e kërkesës e konsideroi se duhet të zbatohet në rastin e saj, parashikonte një sërë sanksionesh për shkeljet e atij ndalimi. Sipas mendimit të Gjykatës, nga ato ndryshime legjislative ishte e qartë se ligjvënësi kishte konsideruar edhe atëherë se shkeljet e ndalimit të zbulimit të informacionit nga gjyqtarët do të shqyrtoheshin në dritën e gamës së plotë të sanksioneve në dispozicion në sferën e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve. Rrjedhimisht, ajo vlerësoi se nuk mund të thuhet se autoritetet vendase kishin zbatuar standardet përkatëse që rrjedhin nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me nenin 10 të Konventës dhe se, në çdo rast, sanksioni i shqiptuar ndaj parashtrueses së kërkesës nuk dukej i nevojshëm në një shoqërinë demokratike.

* **Gjykatat serbe shkuan shumë larg në kritikën e tyre ndaj raportimit të kompanisë transmetuese mbi polemikat e vaksinës kundër gripit të derrit (05/09/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin e **Kompanisë Radio Transmetuese B92 AD kundër Serbisë** (kërkesa nr. 67369/16), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me procedurën civile të iniciuar kundër parashtrueses së kërkesës, kompanisë transmetuese, nga ish-ndihmës ministrja e shëndetësisë për raportimin e saj në vitin 2011 se ajo dyshohej për keqpërdorim të detyrës, mes polemikave të vazhdueshme lidhur me prokurimin e vaksinave të gripit të derrit. Gjykata konstatoi se gjykatat serbe kishin pranuar se informacioni i publikuar nga kompania që parashtronte kërkesën kishte kontribuar në një debat publik dhe se dikush në pozitën ndihmës ministres së shëndetësisë duhej të kishte treguar një shkallë më të madhe të tolerancës. Megjithatë, gjykatat kishin shkuar shumë larg në kritikën e tyre ndaj kontrollit të fakteve të kompanisë parashtruese. Kompania e kishte bazuar raportimin e saj në një shënim të marrë nga zyrtarët policor në lidhje me hetimin e polemikave dhe nuk kishte dyshime mbi besueshmërinë e shënimit.

Gjuha e përdorur në raportim ishte e saktë dhe jo e ekzagjeruar, dhe të gjitha palët ishin kontaktuar për të marrë versionin e tyre të ngjarjeve. Gjykata konstatoi se, në përgjithësi, kompania parashtruese kishte vepruar në mirëbesim dhe me kujdes të duhur ashtu siç pritet nga gazetaria e përgjegjshme.



*** Legjislacioni që ul moshën e pensionimit në 60 vjeç për gjyqtarët femra në kundërshtim me Konventën (24/10/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin Pajak dhe të tjerët kundër Polonisë (kërkesat nr. 25226/18, 25805/18, 8378/19 dhe 43949/19), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, me shumicë (5 vota për dhe 2 kundër), se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me të gjithë parashtruesit, dhe **shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit)** në ndërlidhje me nenin 8 (e drejta për respektimin e jetës private) në lidhje me tre parashtruesit që kishin paraqitur ankesa sipas këtyre dispozitave.

Rasti kishte të bënte me katër gjyqtare të cilat paraqitën ankesë lidhur me ndryshimet legjislative që kishin ulur moshën e pensionimit për gjyqtarët nga 67 në 60 vjeç për gratë dhe në 65 vjeç për burrat dhe e kishin kushtëzuar vazhdimin e detyrës së gjyqtarit pas arritjes së moshës së pensionit me autorizimin e Ministrit të Drejtësisë dhe nga Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit ("KKGJ"). Gjykata vlerësoi se gjyqtarët duhet të gëzojnë mbrojtje nga vendimet arbitrare nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv dhe se vetëm mbikëqyrja nga një organ i pavarur gjyqësor i ligjshmërisë së një mase të kontestuar ishte në gjendje ta bënte një mbrojtje efektive. Në rastin konkret, ajo konstatoi se vendimet e marra në lidhje me secilin parashtrues të kërkesës nga Ministri i Drejtësisë dhe nga KKGJ-ja paraqesin ndërhyrje arbitrare dhe të paligjshme, në sferën e pavarësisë së gjyqësorit dhe mbrojtjes nga largimi nga detyra gjyqësore, nga ana e përfaqësuesit të autoritetit ekzekutiv dhe organit vartës të atij autoriteti. Ajo arriti në përfundim se e drejta e parashtruesve për qasje në gjykatë ishte cenuar në këtë mënyrë në thelbin e saj. Gjykata konstatoi gjithashtu se legjislacioni për të cilin ankimohej kishte paraqitur një ndryshim të qartë në trajtim, në bazë të gjinisë, për sa i përket moshës së pensionimit të detyrueshëm për anëtarët e të njëjtit profesion. Ajo vuri në dukje se jeta e punës e parashtruesve pushonte pesë vite më parë se ajo e gjyqtarëve meshkuj në rrethana të ngjashme dhe se pensionimi i tyre i parakohshëm i detyrueshëm kishte pasur pasoja të dukshme negative në karrierën e tyre dhe perspektivat e tyre në drejtim të zhvillimit profesional dhe personal.

*** Nuk ka masa mbrojtëse për zyrtarin e Fondit të Pronës Shtetërore i prekur rastësisht nga masat e përgjimit telefonik (26/10/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin **Plechlo kundër Sllovakisë** (kërkesa nr. 18593/19) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me përgjimin dhe regjistrimin e disa prej bisedave telefonike të z. Plechlo në vitin 2006 në kontekstin e një hetimi penal për korrupsion të dyshuar në Fondin e Pronës Shtetërore – agjencia e privatizimit e vendit. Në atë kohë, z. Plechlo ishte zyrtar i lartë i FPSH-së; megjithatë hetimi penal nuk e kishte prekur drejtpërdrejt atë. Më pas, në vitin 2016, disa nga materialet e përgjuara u përfshinë në dosjen e një hetimi tjetër penal për keqmenaxhimin e pasurive dhe në të cilin z. Plechlo ishte një nga të dyshuarit kryesorë. Ky hetim u zhvillua në kontekst më të gjerë të hetimeve nën dyshimin për korrupsion të nivelit të lartë duke përfshirë FPSH-në, pas regjistrimeve të postuara në mënyrë anonime në internet me pretendimin se e kanë origjinën nga një operacion vëzhgimi, i koduar me emrin "Gorilla", i kryer në vitet 2005-06 nga Shërbimi Informativ Sllovak. Gjykata konstatoi se z. Plechlo, si person i prekur rastësisht nga masat e përgjimit telefonik në vitin 2006, nuk kishte përfituar nga masat mbrojtëse të nevojshme në lidhje me regjistrimin, ruajtjen dhe mbajtjen e vazhdueshme të materialit të përgjimit. Ndërhyrja në të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe korrespondencës nuk ishte shoqëruar me garanci adekuate dhe efektive kundër abuzimit.

*** Shkelja e urdhrit për videon e Bild për arrestimin në klubin e natës në Bremen (31/10/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin **Bild GmbH & Co. KG kundër Gjermanisë** (kërkesa nr. 9602/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Çështja kishte të bënte me një vendim të gjykatës që urdhëronte bild.de, një ueb faqe e madhe lajmesh, të hiqte pamjet e CCTV-së së një arrestimi nga policia në një klub nate në Bremen, nëse nuk fshihte fytyrën e një prej policëve të përfshirë. Gjykata konstatoi në veçanti se arsyetimi i gjykatave gjermane në lidhje me përdorimin e dytë dhe të çdo përdorimi të ardhshëm të filmimit kishte qenë i pamjaftueshëm dhe se arsyetimi mund të çonte në ndalim të papranueshëm për çdo publikim në të ardhmen, pa pëlqimin e individëve në fjalë, të imazheve të paedituara të zyrtarëve policor që kryejnë detyrat e tyre.



*** Vonesat e konsiderueshme në ndjekjen penale të ish-ministrit të Mbrojtjes në shpërthimin e vitit 2008 në objektin e dekompozimit të municioneve në Gërdec (07/11/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin **Durdaj dhe të tjerët kundër Shqipërisë** (kërkesat nr. 63543/09, 46707/13, 46714/13 dhe 12720/14), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **shkelje të aspektit procedural të nenit 2 (e drejta për jetën)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një shpërthim që kishte ndodhur më 15 mars 2008 në një objekt në Gërdec të ngritur nga autoritetet shtetërore për çmontimin e armëve, makinerive dhe pajisjeve të forcave të armatosura të dekompozuar dhe të vjetruara. Gjithsej 26 persona kishin vdekur (përfshirë djalin shtatëvjeçar të dy prej parashtruesve në këtë rast) dhe mbi 300 veta u plagosën (përfshirë 15 parashtrues). Gjykata konstatoi se parashtruesit ishin privuar nga e drejta për të marrë pjesë në mënyrë efektive në gjykimin penal. Për më tepër, procedura penale ndaj ish-ministrit të Mbrojtjes, F.M., për keqpërdorimi të detyrës është ende në pritje, duke i lënë kështu parashtruesit pa një epilog përfundimtar për përgjegjësinë e tij edhe për më shumë se 14 vite pas shpërthimit. Autoritetet shtetërore të ndjekjes penale nuk kishin dhënë shpjegime bindëse për dështimin e tyre për të rifilluar hetimin menjëherë pas rizgjedhjes së F.M. deputet, duke ngritur kështu pikëpyetje serioze për gatishmërinë dhe interesin e tyre për të ndjekur çështjen dhe duke krijuar potencial për mosndëshkim. Ndërsa Gjykata nuk merr qëndrim përkitazi me përgjegjësinë e tij penale, ajo vlerësoi se parashtruesit si dhe publiku i gjerë kishin të drejtë të dinin jo vetëm rrethanat në të cilat kishte ndodhur tragjedia e Gërdecit, por edhe rolin e saktë që Ministri i Mbrojtjes kishte pasur në të.

*** Krijimi jurisprudencial i një afati të ri kohor për paraqitjen e kërkesave në gjykatat administrative nuk ka ndërhyrë në mënyrë të padrejtë në të drejtën për një proces të rregullt, por zbatimi i menjëhershëm në procedurat në vazhdim ishte në kundërshtim me nenin 6 § 1 (09/11/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin **Legros dhe të tjerët kundër Francës** (kërkesat nr. 72173/17 dhe 17 të tjera), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe **shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (mbrojtja**

e pronës) në rastin e z. Legros (kërkesa nr. 72173/17). Gjykata vendosi për ankesat e 18 individëve në lidhje me zbatimin e menjëhershëm në procedurat në vazhdim të një afati të ri për paraqitjen e kërkesave në gjykatat administrative, siç parashikohet nga Conseil d'État në vendimin e tij Czabaj të datës 13 korrik 2016 (Asambleja Gjyqësore, nr. 387763).

Në atë vendim, Conseil d'État kishte përcaktuar parimin se, kur një vendim administrativ nuk njoftonte procedurat dhe afatet kohore për ankesë kundër tij, ishte e mundur që ai vendim të kundërshtohet, në mungesë të afateve specifike ligjore dhe rregullatore, vetëm brenda “një kohe të arsyeshme”, e cila nuk do të kalojë, si rregull i përgjithshëm, një vit nga koha kur personi në fjalë është njoftuar ose është në njohuri të vendimit, përveç rasteve kur parashtruesi demonstroi rrethanat të veçanta. Së pari, Gjykata vlerësoi se krijimi i një kërkesë të re për pranueshmëri përmes interpretimit gjyqësor, mbi arsyet që justifikonin largimin nga praktika gjyqësore që kishte rezultuar në krijimin e një “kohe të arsyeshme” brenda së cilës duhej të parashtrohej çdo kërkesë në gjykatat administrative, nuk ka ndërhyrë në mënyrë të padrejtë në të drejtën për një proces të rregullt, siç sigurohet nga neni 6 § 1 i Konventës, edhe pse ajo mund të prekte vetë thelbin e së drejtës së ankesës. Së dyti, Gjykata konsideroi se zbatimi i menjëhershëm në procedurat në vazhdim i këtij rregulli të ri lidhur me afatin kohor për parashtrim të kërkesave në gjykatat administrative, i cili, për ankuesit, kishte qenë si i paparashikueshëm në parim ashtu edhe i padiskutueshëm në praktikë, kishte kufizuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt deri në atë masë sa që ishte cenuar vetë thelbi i asaj të drejte. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës. Përkitazi me kërkesën nr. 72173/17, si rezultat i faktit se parashtruesi i kërkesës kishte qenë viktimë e shkeljes së nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata konstatoi se kufizimi në fjalë nuk kishte arritur ekuilibrin e drejtë të kërkuar nga neni 1 i Protokollit nr. 1 dhe se për rrjedhojë kishte pasur shkelje të atij neni.

*** Autoritetet shqiptare duhet të identifikojnë dhe ndëshkojnë ata që janë përgjegjës për vrasjen e të afërmeve të parashtruesve gjatë protestës së vitit 2011 para zyrës së kryeministrit (14/11/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin **Nika kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 1049/17) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **dy shkelje të nenit 2 (e drejta për jetë dhe hetim)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Çështja kishte të bënte me vdekjen e bashkëshortit dhe



babait të parashtruesve pasi ishte qëlluar në kokë në vitin 2011 gjatë një demonstrate para zyrës së Kryeministrit shqiptar. Protesta kishte rezultuar në konfrontime të dhunshme mes demonstruesve dhe autoriteteve. Parashtruesit pretenduan në veçanti se komandanti i përgjithshëm i Gardës Kombëtare, i ngarkuar me mbrojtjen e zyrës së Kryeministrit, kishte urdhëruar njerëzit e tij që të hapnin zjarr ndaj protestuesve. Gjykata konstatoi se çështja e përgjegjësisë së mundshme komanduese nuk kishte marrë përgjigje në hetimin që kishte pasuar, i cili ishte fokusuar në përgjegjësinë individuale të oficerëve të Gardës Kombëtare dhe jo në sekuencën ose natyrën e ndonjë urdhri të dhënë nga ata në zinxhirin e tyre komandues. Kishte pasur gjithashtu një sërë mangësish të tjera në hetim, duke përfshirë fshirjen e video-incizimeve të incidentit dhe mosndjekjen e pistave kyçe të hetimit, si p.sh. shenjat e plumbave të gjetura në lartësinë e njeriut në rrethojën e hekurt që rrethon zyrën e Kryeministrit. Mangësitë e tilla ngritën dyshime nëse autoritetet ishin përpjekur të devijonin ose të ndërhyjnë në mënyrë të papërshtatshme në hetim. Gjykata po ashtu gjeti mangësi në kornizën ligjore të atëhershme që rregullonte përdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e operacioneve të kontrollit të turmës dhe defekte serioze në planifikimin dhe kontrollin e protestës. Autoritetet nuk kishin treguar se përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga oficerët e Gardës Kombëtare që kishte rezultuar në vdekjen e të afërmit të parashtruesve kishte qenë absolutisht i nevojshëm. Në të vërtetë, vetë qeveria shqiptare kishte pranuar se përdorimi i forcës kishte qenë i tepruar. Së fundi, ajo konstatoi në bazë të nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve) se autoritetet duhet të vazhdojnë të përpiqen të sqarojnë rrethanat e vdekjes së të afërmit të parashtruesve dhe të identifikojnë dhe ndëshkojnë përgjegjësit.

*** Kërkesa e një shoqate në lidhje me masat kundër Covid-it që ndalonin ngjarjet publike në Zvicër në vitin 2020 ishte e papranueshme (27/11/2023)**

Rasti *Communauté genevoise d'action syndicale (CGAS) kundër Zvicrës* (kërkesa nr. 21881/20) kishte të bënte me masat në fuqi nga data 17 mars deri më 30 maj 2020, të cilat u miratuan nga qeveria zvicerane për të luftuar sëmundjen e koronavirusit 2019 ("COVID-19"). Duke u mbështetur në nenin 11 (liria e tubimit dhe e organizimit) të Konventës, shoqata parashtruese u ankua për ndalimin e plotë të ngjarjeve publike që kishin rezultuar nga "Urdhëresa për COVID-19 nr. 2", në versionin në fuqi gjatë periudhës së sipërpërmendur. Në vendimin e saj të Dhomës së Madhe, Gjykata Evropiane për të Drejtat e

Njeriut vendosi se kërkesa ishte e papranueshme në kuptim të nenit 35 të Konventës.

- Gjykata vlerësoi njëzëri se ankesa në lidhje me lirinë e sindikatave binte jashtë fushëveprimit të rastit të paraqitur në Dhomën e Madhe dhe se, në çdo rast, ishte e papranueshme për mosrespektimin e afatit gjashtëmuor (neni 35 i Konventës në fuqi në kohën përkatëse). Kjo ankesë e re ishte ngritur për herë të parë në kuadër të procedurave para Dhomës së Madhe; ajo është dashur të ishte paraqitur, më së voni, brenda gjashtë muajve nga data 30 maj 2020, datë në të cilën Urdhëresa për COVID-19 nr. 2 kishte pushuar së aplikuari.

- Me shumicë (12 vota për dhe 5 kundër), Gjykata vlerësoi se ankesa në lidhje me lirinë e tubimit paqësor ishte e papranueshme për mosshterjen e mjeteve juridike të brendshme. Gjykata vuri në dukje se shoqata parashtruese nuk kishte ndërmarrë hapat e duhur për t'u mundësuar gjykatave kombëtare të përmbushin rolin e tyre themelor në sistemin e mbrojtjes së Konventës. Gjykata theksoi, në veçanti, se kërkesa për vendim paraprak mbi kushtetutshmërinë, e paraqitur në kontekstin e një ankese të zakonshme kundër një vendimi për zbatimin e urdhëresave federale, ishte mjet juridik i cili drejtpërdrejt ishte i qashtëm për palët ndërgjyqëse dhe bënte të mundur, kur ishte e përshtatshme, shpalljen antikushtetuese të dispozitës së kundërshtuar. Nuk kishte pasur asnjë rrethanë të veçantë që do ta lironte shoqatën parashtruese nga detyrimi për të shtetur mjetin juridik të mësipërm. Duke përsëritur rolin e saj ndihmës, Gjykata specifikoi se, në kontekstin e paprecedentë dhe shumë të ndjeshme

të pandemisë COVID-19, ishte gjithnjë e më shumë e rëndësishme që autoriteteve kombëtare fillimisht t'u jepej mundësia për të vendosur një ekuilibër mes interesave konkurruese private dhe publike ose mes të drejtave të ndryshme të mbrojtura nga Konventa, duke marrë parasysh nevojat dhe kushtet lokale si dhe gjendjen e shëndetit publik që kishte ekzistuar në kohën përkatëse.

*** Gjykata Supreme ishte e paanshme në rastin e komplotit për të ndikuar në ankesën për krime të luftës (28/11/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin *Tadić kundër Kroacisë* (kërkesa nr. 25551/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 2 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me procedurat penale në të cilat z. Tadić ishte shpallur fajtor për komplot – përmes pagesave të parave – për



të ndikuar në Gjykatën Supreme për të dhënë një vendim të favorshëm për një politikan të njohur që po gjykohej për një krim të luftës. Gjykata konstatoi në veçanti se përfshirja e Presidentit të Gjykatës Supreme në gjykimin kundër z. Tadiq nuk e kishte dëmtuar paanshmërinë objektive të asaj gjykate. Ai kishte pasur shumë pak ndikim real për të imponuar vullnetin e tij mbi gjyqtarët e tjerë, dhe në çdo rast nuk kishte pasur asnjë çështje në lidhje me mënyrën se si Gjykata Supreme e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Gjykata konstatoi gjithashtu se vendimi i apelit nuk ishte ndikuar nga publikimet e mediave. Ai ishte marrë nga gjyqtarë profesionistë të Gjykatës Supreme në bazë të shkresave të lëndës dhe duke trajtuar faktet e identifikuar nga gjykatat e shkallës së parë dhe duke zbatuar ligjin.

*** Viktima e trafikimit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga trafikanti (28/11/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin **Krachunova kundër Bullgarisë** (kërkesa nr. 18269/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **shkelje të nenit 4 (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me përpjekjet e znj. Krachunova për të marrë kompensim për të ardhurat nga puna seksuale që X, trafikanti i saj, i kishte marrë prej saj. Gjykatat bullgare kishin refuzuar kompensimin, duke deklaruar se ajo ishte angazhuar në prostitucion dhe kthimi i të ardhurave nga kjo do të ishte në kundërshtim me “moralin e mirë”. Gjykata vendosi se shtetet kishin për detyrim t’u mundësonin viktimave të trafikimit që të kërkojnë kompensim për fitimet e humbura nga trafikantët, dhe se autoritetet bullgare nuk kishin arritur të balanconin të drejtën e znj. Krachunova sipas nenit 4 për të bërë një kërkesë të tillë me interesat e komunitetit, i cili nuk pritej të konsideronte të pandershme pagesën e kompensimit në një situatë të tillë. Kjo ishte hera e parë që Gjykata Evropiane kishte konstatuar se një viktimë trafikimi kishte të drejtë të kërkonte kompensim në lidhje me dëmin material nga trafikanti i saj sipas nenit 4.

*** Duke marrë pjesë në një rast edhe pse kishin kontakte të rregullta profesionale me njërin nga palët, gjyqtarët e Gjykatës së Kasacionit ngritën dyshime legjitime mbi paanshmërinë e tyre objektive: shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës (14/12/2023)**

Në vendimin e Dhomës në rastin **Syndicat National des Journalistes dhe të tjerët kundër Francës** (kërkesa nr. 41236/18), Gjykata Evropiane për të

Drejtat e Njeriut vendosi, njëzëri, se kishte pasur **shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Çështja kishte të bënte me një shkelje të pretenduar të së drejtës për një proces të rregullt nga një gjykatë e paanshme, si rezultat i përfshirjes së tre gjyqtarëve të Gjykatës së Kasacionit – të cilët, sipas parashtresve, kishin lidhje me palën kundërshtare – në shqyrtimin e ankesës së tyre për pikat e ligjit. Në rastin konkret, të paktën dy nga tre gjyqtarët në fjalë kanë punuar rregullisht në kompaninë ligjore botuese e cila ishte një nga palët në kontestin e ndarjes së fitimit. Në kuadër të një operacioni ristrukturimi brenda kompanisë botuese mëmë, ishte marrë një kredi prej 445 milionë euro për të blerë aksionet e kompanive të mbyllura të grupit, gjë që kishte rezultuar në një nivel borxhi që përjashtonte çdo pagesë për punonjësit nën skema e detyrueshme e ndarjes së fitimit. Gjykata theksoi, së pari, se kontributi i gjyqtarëve në përhapjen e ligjit, veçanërisht nëpërmjet ngjarjeve kërkimore, aktiviteteve mësimore ose publikimeve, ishte qartësisht pjesë e rolit të tyre. Megjithatë, më pas, ajo konsideroi se kontaktet profesionale ndërmjet gjyqtarëve të caktuar dhe njëres prej palëve në proces kishin qenë të rregullta, të ngushta dhe të kompensueshme, gjë që ishte e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se këta gjyqtarë duhej të tërhiqeshin nga gjykimi në këtë çështje, siç kishte konstatuar edhe Komisioni i Shërbimit Ligjor Kombëtar (Conseil supérieur de la magistrature). Ajo arriti në përfundimin se frika e sindikatave parashtresë lidhur me mungesën e paansisë së gjyqtarëve ishte justifikuar objektivisht. Prandaj, kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

*** Gjobat për mësimdhënësit grevistë me statusin e nëpunësit civil nuk kanë shkelur të drejtat (14.12.2023)**

Në vendimin e Dhomës së Madhe në rastin **Humpert dhe të tjerët kundër Gjermanisë** (kërkesa nr. 59433/18 dhe 3 të tjerë), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, me 16 për dhe 1 kundër, se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 11 (liria e tubimit dhe e organizimit)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me sanksionet disiplinore të shqiptuara ndaj parashtresve, mësimdhënësit me status të nëpunësit civil, për pjesëmarrje gjatë orarit të tyre të punës në grevat e organizuara nga sindikata e tyre për të protestuar kundër përkeqësimit të kushteve të punës për mësimdhënësit. Gjykata konstatoi në veçanti se ndalimi i grevës nga mësimdhënësit me



asaj statusin e nëpunësit civil – i cili ishte në fuqi për të garantuar përmbushjen e funksioneve të shtetit nëpërmjet administratës publike efektive, duke përfshirë ofrimin e arsimit – nuk e bënte josubstanciale lirinë e tyre sindikaliste, pasi që shumëllojshmëria e masave të ndryshme mbrojtëse institucionale që ishin vendosur u mundësonin nëpunësve civilë dhe sindikatave të tyre të mbronin në mënyrë efektive interesat e tyre profesionale. Si rezultat, Gjykata konstatoi se masat disiplinore ndaj parashtruesve pas pjesëmarrjes së tyre në greva kishin qenë brenda diskrecionit të shtetit (“marzhës së vlerësimit”).

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int)

INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 1 937 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org

Ueb: www.gjk-ks.org